



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 551/ 8 prot.

Datë 30.03.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 443/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Udha*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “*Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njesisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë*”, me fond limit 197’903’543 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Bami Holding*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “*Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njesisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë*”, me fond limit 197’903’543 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “*Udha*” SHPK me NIPT K77524909Q me adresa: Lagjia “*Pjetër Budi*”, Rruga “*Qamil Xhika*”, Nd. 31, Burrel.

Operatori ekonomik “*Bami Holding*” SHPK me NIPT J94416206R, me adresa: Rruga Kameron, Krujë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Krujë.  
Adresa: Sheshi “Mustafa Merlika (Kruja)”, Krujë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 04.11.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “Sistemi

*Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë”, me fond limit 197’903’543 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.*

II.2. Në datën 19.11.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 12.12.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “RSM Construction” dshh & “RSM Company” SHPK & “Biba X” SHPK	128,458,606 lekë	skualifikuar
2. “Shpresa AI” SHPK	146,565,622.63 lekë	kualifikuar
3. “Shëndelli” SHPK	149,380,147 lekë	kualifikuar
4. BOE “BE-IS” SHPK & “Ergi” SHPK	155,445,660 lekë	kualifikuar
5. “Curri” SHPK	155,670,050.13 lekë	kualifikuar
6. BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK	160,767,592.85 lekë	kualifikuar
7. BOE “Makareshi” SHPK & “B 93 II” SHPK & “Beqiri” SHPK	161,286,212 lekë	skualifikuar
8. “Udha” SHPK	161,928,268.14 lekë	kualifikuar
9. “Pepa Group” SHPK	162,033,632.72 lekë	kualifikuar
10. “Ndregjoni” SHPK	164,688,981.59 lekë	kualifikuar
11. BOE “Kegli Duri” SHPK & “Varaku E” SHPK & “LTE Construction” SHPK	165,895,056.86 lekë	skualifikuar
12. “Bami Holding” SHPK	172,235,914.02 lekë	kualifikuar
13. BOE “Almo Konstruksion” SHPK & “K. Turja” SHPK	177,248,275 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 15.12.2025, nëpërmjetë sistemit të prokurimeve elektronike nga rubrika kërkesa autoriteti kontraktor i është drejtuar operatorit ekonomik “Udha” SHPK, si më poshtë vijon:

Krujë më 15.12.2025

*Lënda: Ftesë për paraqitje dokumentacioni provues të ofertës.*

*Objekti i Prokurimit: “Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë.”*

*Drejtuar: “UDHA” sh.p.k*

*Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se subjekti “UDHA” sh.p.k me nr. NIPT K77524909Q dhe adresë Lagjja Pjetër Budi Burrel 8001 me administrator Z.Arben Çela, se oferta e paraqitur me vlerë totale 161.928.268,14 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e*

*nëntëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë presje katërmbëdhjetë) lekë pa t.v.sh /totali i pikëve të marra [nuk ka vleresim me pikë ose sipas rastit kur ka vleresim me pikë] është identifikuar si Oferta e suksesshme. Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Krujë, Sheshi Mustafa Merlika (Kruja ), Kati i II Zyra e Prokurimeve Publike, dokumentat provuese të ofertës së tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi, në SPE.*

*Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi në përputhje me kërkesat e nenit , 76.3.ë, 82.5 të Ligjit nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë ose nuk dorëzoni (dokumentacionin provues të ofertes), brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.*

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 11.02.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “RSM Construction” dshh & “RSM Company” SHPK & “Biba X” SHPK	128,458,606	lekë	skualifikuar
2. “Shpresa AI” SHPK	146,565,622.63	lekë	skualifikuar
3. “Shëndelli” SHPK	149,380,147	lekë	skualifikuar
4. BOE “BE-IS” SHPK & “Ergi” SHPK	155,445,660	lekë	skualifikuar
5. “Curri” SHPK	155,670,050.13	lekë	skualifikuar
6. BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK	160,767,592.85	lekë	skualifikuar
7. BOE “Makareshi” SHPK & “B 93 II” SHPK & “Beqiri” SHPK	161,286,212	lekë	skualifikuar
8. “Udha” SHPK	161,928,268.14	lekë	skualifikuar
9. “Pepa Group” SHPK	162,033,632.72	lekë	skualifikuar
10. “Ndrejoni” SHPK	164,688,981.59	lekë	skualifikuar
11. BOE “Kegli Duri” SHPK & “Varaku E” SHPK & “LTE Construction” SHPK	165,895,056.86	lekë	skualifikuar
12. “Bami Holding” SHPK	172,235,914.02	lekë	skualifikuar
13. BOE “Almo Konstruksion” SHPK & “K. Turja” SHPK	177,248,275	lekë	skualifikuar

II.6. Në datën 11.02.2026, operatori ekonomik “Udha” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

*Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik “Udha” sh.p.k, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se: Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3.7 të Dokumentave Standarde të Tenderit-, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik që nevojiten në ekzekutimin e kontratës.*

*Për mjetin me targë AA 251 HE, të deklaruar kamioncinë nën 3.5 ton, referuar dokumentacionit provues, në lejen e qarkullimit me nr.PED0112115 pika 23.Masa maksimale e autorizuar është 7490 kg. Gjithashtu, në çertifikatën e kontrollit teknik mjeti i përket kategorisë N2 (Kamion) dhe në çertifikatën e pronësisë së mjetit është E7-Kamion me vinç i montuar. Nga këto të dhëna rezulton se mjeti tejkalon tonazhin e kërkuar, duke mos përmbushur kriterin 2.3.7 për “Kamioncinë nën 3.5 ton” i cili sipas ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” neni 47, pika 2 (c) Kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3.5 ton ndërsa N2 (Kamion): mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë me të madhe se 3.5 ton dhe jo me të madhe se 12 ton, si dhe neni 54 pika 1(c).*

*Për mjetin e deklaruar autobot uji me targë AA687DR, nga dokumentacioni i paraqitur, sipas lejes së qarkullimit, (J.1)- Destinacioni dhe përdorimi i mjetit, rezulton automjet për transport mallrash të rrezikshëm, i cili nga natyra dhe destinacioni i përdorimit nuk përputhet me mjetin e kërkuar dhe të deklaruar për këtë procedurë.Çdo ndryshim i kryer në destinacionin e përdorimit të mjetit duhet të reflektohet në lejen e qarkullimit. Për rrjedhojë, kërkesa e kriterit sipas pikës 2.3.7, nuk konsiderohet e plotësuar.*

*Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3-6 (a) të Dokumentave Standarde të Tenderit- Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 8 (tetë) punonjës manovratorë të mjeteve/makinerve të rënda specifikisht sipas profileve te mëposhtme:*

- *Manovrator asfaltoshtruese→1 manovrator.*
- *Manovrator eskavatori→1 manovrator.*
- *Manovrator grejderi→1 manovrator.*
- *Manovrator rruli vibrues →2 manovrator.*
- *Manovrator rruli asfalti →1 manovrator.*
- *Manovrator makinerie skarifikimi asfalti→1 manovrator.*
- *Manovrator Autovinçi→1 manovrator.*

*Për cdo profil punonjesi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates), dëshmite e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet perkatëse sipas modaliteteve te urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019.*

*Sipas urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019, neni 8 dhe kërkesa e DST-së pika 2.3-6 (a), kërkohen specifikisht manovratorët si më poshtë:*

- 1 (një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për Eskavatorist (Manovrator eskavatori).
- 6 (gjashtë) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist (1 Manovrator asfaltoshtruese; 1 Manovrator grejderi; 2 Manovrator rruli vibrues; 1 Manovrator rruli asfalti; 1 Manovrator makinerie skarifikimi asfalti).
- 1 (një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për Automakinist (Manovrator Autovinçi). Operatori ekonomik “Udha” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin provues për punonjës manovratorë të mjeteve/makinerive të rënda sipas dëshmive të aftësisë profesionale si më poshtë:
- 1 (një) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Eskavatorist
- 3 (tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist
- 4 (katër) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Automakinist

*Për rrjedhojë, mungojnë 3 (tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist, nga 6 (gjashtë) të kërkuar dhe kërkesa e kriterit 2.3-6(a) nuk konsiderohet e plotësuar. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur është në kundërshtim me pikën 2.3.7 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës dhe 2.3.6 (a) Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik dhe përbën kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik “Udha” sh.p.k. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion e vlefshëm sipas kërkesave të nenit 82.5 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

II.7. Në datën 16.02.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim anulimit në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Në datën 21.02.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2026/6356 dhe me numër 551/2026 prot., datë 23.02.2026 e operatorit ekonomik “Udha” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “Sistemi i Asfaltimit të Rrugëve në territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë”, me fond limit 197’903’543 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e skualifikimit të operatorit ekonomik “Udha” SHPK me përmbajtje si mëposhtë vijon:

*Ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i vlerësimit të Ofertave në vendimin e saj, ne, operatorit ekonomik pjesëmarrës “Udha” Sh.p.k., plotësojmë të gjitha kushtet për kualifikim të përcaktuara në DST, ku më hollësisht ju parashtrijmë argumentat dhe faktet ligjore, si më poshtë:*

II.1 E kundërshtojmë s’kualifikimin tonë, me arsyetimin e KVO-s, se: OE “Udha” nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7 të Dokumentave Standarde të Tenderit-, dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik që nevojiten në ekzekutimin e kontratës, për arsyet, si më poshtë:

1. Sipas njoftimit të Autoritetit Kontraktor, skualifikimi i operatorit tonë është bërë mbi bazën e pretendimit se: a. Për mjedin me targë AA 251 HE, të deklaruar kamioncinë nën 3.5 ton, referuar dokumentacionit provues, në lejen e qarkullimit me nr. PED0112115 pika 23. Masa maksimale e autorizuar është 7490 kg. Gjithashtu, në certifikatën e kontrollit teknik mjedi i përket kategorisë N2 (Kamion) dhe në certifikatën e pronësisë së mjedit është E7-Kamion me vinc i montuar. Nga këto të dhëna rezulton se mjedi tejkalon tonazhin e kërkuar, duke mos përmbushur kriterin 2.3.7 për “kamioncin” nën 3.5 tonë i cili sipas ligjit nr. 8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” neni 47, pika 2 (c) Kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3.5 ton ndërsa N2 (Kamion): mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë me të madhe se 3.5 ton dhe jo me të madhe se 12 ton, si dhe neni 54 pika 1 (c).

Per sa i perket kesaj pike skualifikimi argumentojme si me poshte:

Ne DST, Pika 2.3.7 e saj, eshte kerkuar nder te tjera qe Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera ku nga keto mjete figuron mjedi kamiondine nën 3.5 ton.

Ne si operator ekonomik kemi paraqitur ne permbushje te ketij kriteri kamioncinen me targë AA 251 HE, ku ne lejen e qarkullimit masa maksimale e autorizuar e mjedit dhe masa bosh e mjedit jane respektivisht 7490 kg dhe 4680 kg, pra kamioncina eshte me peshe mbajttese 2810 kg. Kamioncina ne kete rast e permbush kriterin pasi ne DST nuk eshte percaktuar se cfare tonazhi specifik duhet te kete ky mjet. Gjithashtu duke qene se ky mjet nuk eshte percaktuar se me cfare kapaciteti konkret kerkohet te jete nen 3.5 ton eshte abuzive te kerkohet skualifikimi i nje operatori per kete arsye:

Kriteri 2.3.7 i tenderit kërkon ikamioncinë nën 3.5 tonë - ky term zakonisht i referohet peshës maksimale me ngarkesë = 3.5 ton (kategoria N1 për transport mallrash), jo mam totale. Nëse autoriteti kontraktor e interpreton si mam = 3.5 ton, kjo është gabim sepse:

Shkel parimin e proporcionalitetit (neni 2 i Ligjit 162/2020) në kriteri duhet të jetë i lidhur me nevojën reale të prokurimit (p.sh. Qarkullim pa patentë C1, taksë më e ulët, akses në zona të kufizuara), jo me një vlerë teknike që nuk reflekton kapacitetin real të transportit.

Shkel parimin e barazisë dhe konkurrencës (neni 2) - mjetet speciale me vinc (të zakonshme për punë ndërtimi ose mirëmbajtjeje) skualifikohen padrejtësisht, ndërkohë që plotësojnë funksionalitetin e kërkuar.

Në certifikatat zyrtare (kontroll teknik + pronësi), mjedi juaj deklarohet si i aftë për transport mallrash nën 3.5 ton efektiv (edhe pse N2 për konfigurim special).

Skualifikimi bazohet në një interpretim të gabuar të nenit 47 të Kodit Rrugor, duke ngatërruar peshën maksimale me ngarkesë (që përcakton N1/N2 për transport mallrash) me masën maksimale autorizuar totale (që përfshin vinain). Mjedi plotëson kriterin funksional të kamioncines nën 3.5 tonë sepse kapaciteti real i transportit të mallrave është brenda limitit 3.5 ton, pavarësisht mam-së më të lartë për shkak të vincit të montuar. Kërkojme shfuqizimin e kesaj arsyeje skualifikimi referuar shkeljes se ligjit te bere nga ana juaj nga mosspecifikimi i bere i cili

krijon paqartesi dhe bie ne kundershtrim me parimin e transparences dhe proporcionalitetit te prokurimit publik. Gjithashtu AK ne rastin e ketij skualifikimi ka vepruar ne kundershtrim me rregullat e prokurimit publik, vendimet e KPP, praktikat e prokurimit dhe gjithashtu ka perdorur standart te dyfishte ne rastin e kualifikimit ne rastin e pare dhe skualifikimit ne rastin e dyte.

B. Për mjetin e deklaruar autobot uji me targë AA 687 DR, nga dokumentacioni i paraqitur, sipas lejes së qarkullimit, (J.1)- Destinacioni dhe përdorimi i mjetit, rezulton automjet për transport mallrash të rrezikshëm, i cili nga natyra dhe destinacioni i përdorimit nuk përputhet me mjetin e kërkuar dhe të deklaruar për këtë procedurë. Cdo ndryshim i kryer në destinacionin e përdorimit të mjetit duhet të reflektohet në lejen e qarkullimit.

Per sa i perket kesaj pike skualifikimi argumentojme si me poshte:

Ne DST, Pika 2.3.7 e saj, eshte kerkuar nder te tjera qe Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera ku nga keto mjete figuron mjete Autobot Uji.

Referuar dispozitave dhe kerkesat e Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", neni 109 e në vijim, si shkelje e parimeve të barazisë, proporcionalitetit, transparencës dhe vlerësimit të drejtë): 1. Kërkesa e tenderit zakonisht specifikon funksionalitetin, jo fjalën e saktë në lejen e qarkullimit. Ju kerkoni qe per ndertimin e rrugeve, operatori ekonomik te disponoje nje Autobot Uji. Në shumicën e procedurave të prokurimit për "Autobot uji", kriteri kryesor është aftësia funksionale për të transportuar dhe shpërndarë ujë (me pompë, spërkatës, kapacitet litrash, etj.), jo emërtimi i saktë në lejen e qarkullimit. Nëse DT (dokumentet e tenderit) nuk e përjashton shprehimisht mjetet që kanë pasur ose kanë destinacion "transport mallrash të rrezikshëm", por kanë qenë të konvertuara/rihomologuara për ujë të pijshëm ose industrial, interpretimi është i ngushtë dhe jo proporcional (shkel nenin 2 dhe nenin 3 të Ligjit 162/2020 - parimi i proporcionalitetit dhe trajtimi i barabartë). Në praktikën shqiptare (dhe në auditimet e KLSH-së), cisternat e vjetra për naftë/karikues kimikë shpesh riconvertohen për ujë (larje rrugësh, ndërtim, etj.) Pas pastrimit, testimit dhe miratimit. Nëse mjete plotëson specifikimet teknike (kapacitet, pompë presion, spërkatës anësor/rrugë, etj.), ai është funksionalisht i njëjtë me një autobot të ri. Skualifikimi vetëm për shkak të fjalës në leje (pa verifikuar gjendjen aktuale) krijon diskriminim dhe kufizon konkurrencën (shkel nenin 2 - barazi dhe konkurrencë e lirë). Sa me siper, ju si AK, ne kete rast keni bere Shkelje e parimeve të Ligjit për Prokurimin Publik, konkretisht:

Neni 2 (parimet): Proporcionalitet - kriteri i destinacionit në leje duhet të jetë i lidhur drejtpërdrejt me nevojën reale (p.sh. Siguria e ujit, mosndotja e rrugës). Nëse mjete transporton vetëm ujë të pastër, rreziku i imallrave të rrezikshëm është zero.

Neni 3 (trajtim i barabartë dhe jodiskriminues): Interpretimi i tillë favorizon vetëm mjetet e reja/fabrike si autobot uji dhe përjashton mjetet e konvertuara, që janë të zakonshme dhe më ekonomike.

Neni 18 (specifikimet teknike): Duhet të jenë të qarta, jo diskriminuese dhe të bazuara në performancë funksionale, jo në emërtim administrativ. Autoboti i paraqitur, ka dokumentacionin e plote dhe te sakte, dhe per me teper ka kaluar kontrollin teknik pra eshte i afte per perdorim.

*Nga pikëpamja teknike, uji nuk paraqet rrezik kontaminimi ose sigurie, siá vërtetohet nga funksionimi normal i tij dhe transporti i tij do të behet për ndertimin e një rruge dhe jo për përdorim nga njerëzit. Gjithashtu vlen të theksohet se ky skualifikim është pa logjike juridike pasi një autobus i cili në leje qarkullimi ka mbetjet e rrezikshme, mund ta transportojë pa asnjë lloj problemi ujë. Gjithashtu kjo arsye nuk ndikon thelbesisht procedurën e prokurimit pasi mjeti dhe dokumentacioni i paraqitur vlen për transportin e ujit gjatë ndertimit të rrugës. AK në rastin e këtij skualifikimi ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, vendimet e KPP, praktikën e prokurimit dhe gjithashtu ka përdorur standart të dyfishtë në rastin e kualifikimit në rastin e parë dhe skualifikimit në rastin e dytë.*

*C. Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3-6 (a) të Dokumentave Standarde të Tenderit- Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 8 (tetë) punonjës manovratorë të mjeteve/makinerve të rënda specifikisht sipas profileve të mëposhtme:*

*Manovrator asfaltshtruese 1 manovrator  
Manovrator eskavatori 1 manovrator  
Manovrator grejderi 1 manovrator  
Manovrator rruli vibrues 2 manovrator  
Manovrator rruli asfalti 1 manovrator  
Manovrator makinerie skarifikimi asfalti 1 manovrator,  
Manovrator Autovinci 1 manovrator*

*Për çdo profil punonjësi teknik si më sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (përgjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse sipas modaliteteve të urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019. Sipas urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019, nëni 8 dhe kërkesa e DST-së pika 2.3-6 (a), kërkohen specifikisht manovratorët si më poshtë:*

*1 (një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për Eskavatorist (Manovrator eskavatori)  
6 (gjashtë) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist (1 Manovrator asfaltshtruese; 1 Manovrator grejderi; 2 Manovrator rruli vibrues; 1 Manovrator rruli asfalti; 1 Manovrator makinerie skarifikimi asfalti)  
1 (një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për Automakinist (Manovrator Autovinci)*

*Operatori ekonomik i udhës sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin provues për punonjës manovratorë të mjeteve/makinerve të rënda sipas dëshmitë të aftësisë profesionale si më poshtë:  
1 (një) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Eskavatorist  
3 (tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist  
4 (katër) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Automakinist*

*Për rrjedhojë, mungojnë 3 (tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist, nga 6 (gjashtë) të kërkuar dhe kërkesa e kriterit 2.3-6 (a) nuk konsiderohet e plotësuar. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur është në kundërshtim me pikën 2.3.7 dëshmi për mjetet e*

pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës dhe 2.3.6 (a) Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik dhe përbën kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik “Udha” sh.p.k. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion e vlefshëm sipas kërkesave të nenit 82.5 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Sqarojme si me poshte:

Shoqeria Udha sh.p.k, sipas kerkesave të ligjit dhe kerkesave të DST-se ka paraqitur Formularin e Vetedeklarimit, ne të cilin janë deklaruar manovratorët:

1. Z. E P, me profesion Manovrator, i punesuar prane shoqerise tone ne rolin e Manovratorit të Asfaltoshtrueses.

2. Z. N B, me profesion Manovrator, i punesuar prane shoqerise tone ne rolin e Manovratorit të Grejderit.

3. Z. F H, me profesion Manovrator, i punesuar prane shoqerise tone ne rolin e Manovratorit të Rrullit Vibrues.

4. Z. L Xh, me profesion Manovrator, i punesuar prane shoqerise tone ne rolin e Manovratorit të Rrullit Vibrues.

5. Z. G C, me profesion Manovrator, i punesuar prane shoqerise tone ne rolin e Manovratorit të Makinerise se skarifikimit të asfaltit.

6. Z. Sh C, me profesion Manovrator, i punesuar prane shoqerise tone ne rolin e Manovratorit të Autovincit.

7. Z. E S, me profesion Manovrator, i punesuar prane shoqerise tone ne rolin e Manovratorit të Eskavatorit me ane të kontrates se qerases të mjeteve Nr.1900. Rep, Nr.809. Kol, Date 18.11.2025.

8. Z. V K, me profesion Manovrator, i punesuar prane shoqerise tone ne rolin e Manovratorit të Rrullit të Asfaltit me ane të kontrates se qerases të mjeteve Nr.1900. Rep, Nr.809. Kol, Date 18.11.2025.

Ne DST, është kerkuar si me poshte:

2.3-6-Personeli mbeshtetes i kualifikuar dhe teknik a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 8 (tete) punonjës manovratorë të mjeteve/makinerive të rënda specifikisht sipas profileve të mëposhtme:

Manovrator asfaltoshtruese 1 manovrator

Manovrator eskavatori 1 manovrator

Manovrator grejderi 1 manovrator

Manovrator rrulli vibrues 2 manovrator

Manovrator rrulli asfalti 1 manovrator

Manovrator makinerie skarifikimi asfalti 1 manovrator

Manovrator Autovinci 1 manovrator

Për cdo profil punonjesi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhes se realizimit të kontrates), dëshmite e aftesise profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet perkatese sipas modaliteteve të urdhrorit Nr. 200, datë

16.5.2019 Shenim- Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr. 8, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar.

Per te provuar dokumentacionin e paraqitur ne formular, ne si shoqeri kemi dorezuar prane AK, Kontratat e Punes per manovratorët dhe deshmitë e aftesive profesionale te tyre te gjitha te vlefshme si dhe kontraten e qerases Nr.1900. Rep, Nr.809. Kol, Date 18.11.2025, ne te cilen specifikohet konkretisht tek detyrimet e qeradhenesit qe shoqeria qeradhenese do te vere ne dispozicion punonjesit E S dhe V K per te operuar mjetet e marra me qera per llogari te qeramarresit. Pra numri total i manovratoreve eshte plotesuar sipas kerkesave te DST per 8 Manovratore.

Kontrata Nr.1900. Rep, Nr.809. Kol, Date 18.11.2025, eshte specifike per objektin ne fjale sic eshte specifikuar ne nenin 4 te saj. Pra manovratorët do te jene ne dispozicion per kete objekt bashke me mjetet.

Autoriteti kontraktor sipas nenit 75 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (pika 1 dhe 2):

Autoriteti kontraktues (AK) mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë sqarime, plotësime ose korrigjime të dokumentacionit të paraqitur, vecanërisht për aspektet teknike, financiare ose kualifikuese, pa ndryshuar thelbin e ofertës.

Ky sqarim lejohet kur dokumentacioni ka mungesa formale ose teknike jo esenciale, që nuk ndikojnë në aftësinë reale për të kryer kontratën.

Skualifikimi është masa e fundit dhe aplikohet vetëm kur ka mospërmbushje thelbësore që e bën ofertën të paaftë për ekzekutim (neni 82, pika 5 dhe neni 83).

DST-ja kërkon minimalisht 8 manovratorë me profile specifike + kontrata/DAP të vlefshme dhe ne kemi ofruar 8 manovratore sipas kesaj kerkese dhe per me teper, DST-ja nuk kërkon numër të ngurtë DAP-sh sipas kategorive të Urdhrit 200 - ajo kërkon personel sipas profileve specifike të makinerive.

Sipas kategorive të Urdhrit 200, DAP është vetëm certifikim aftësie, Interpretimi i AK-së shton një kërkesë jo të shkruar në DST (saktësisht 6 DAP Buldozierist), cka shkel nenin 2 të Ligjit 162/2020 (proporcionalitet, moskufizim konkurrencë).

Në praktikë, një punonjës me DAP Buldozierist mund të operojë makineri të ndryshme brenda grupit (si rrul vibruës, grejder, asfaltoshtruese etj.), por jo të gjitha njëkohësisht - prandaj numri i punonjësve është ai që ka rëndësi reale për ekzekutim, jo numri i DAP-ve të njëjtë. Kontrata e qirasë vërteton disponueshmërinë e personelit shtesë - kjo është e pranueshme sipas nenit 26.6 të VKM 285/2021 (dokumentacion provues për personel që mund të vihet në dispozicion ).Nuk ka rrezik që kontrata të mos realizohet për shkak të këtij pretendimi - prandaj skualifikimi është i padrejtë dhe disproporcional (shkel nenin 2: proporcionalitet, barazi, konkurrencë e lirë). Ne kete rast, kjo është një çështje teknike jo esenciale që nuk pengon aftësinë tone për të ekzekutuar

kontratën. Sipas nenit 75 të Ligjit 162/2020, AK-ja duhet të ketë kërkuar sqarim plotësues para skualifikimit.

Ne, si operatori ekonomik "Udha" sh.p.k, pranojmë që interpretimi ynë fillestar për numrin e DAP-ve "Buldozierist" mund të ketë qenë optimist në raport me pritshmëritë e Autoritetit Kontraktues. Megjithatë, ne besojmë se skualifikimi i menjëhershëm është një masë e tepruar dhe jo proporcionale me realitetin e ofertës sonë, për arsyet e mëposhtme: Ne kemi paraqitur një strukturë plotësisht funksionale dhe reale për të siguruar 8 manovratorë me profilet e kërkuara:

Kemi kontrata pune të vlefshme për 6 punonjës kryesorë, secili me DAP të vlefshme që certifikon aftësinë profesionale për makineritë përkatëse.

Për dy profilet e mbetura (Manovrator eskavatori dhe Manovrator rruli asfalti) kemi paraqitur kontratën e qirasë Nr. 1900.Rep / Nr. 809.Kol, datë 18.11.2025, në të cilën qiradhënësi angazhohet zyrtarisht të vërë në dispozicion të nesh punonjësit E S dhe V K - të dy me aftësi profesionale të certifikuara përkatëse - gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës. Kjo strukturë plotëson fjalët e sakta të pikës 2.3-6 (a) dhe 2.3.7 të DST-së: "Duhet të ketë të punësuar minimalisht 8 punonjës manovratorë ose mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomikë".

Ne kemi ofruar dokumentacionin provues që vërteton disponueshmërinë reale dhe të garantuar të personelit, jo vetëm një deklaratë boshe. Nëse Autoriteti Kontraktues konsideron se ka një mangësi numerike në etiketat e DAP-ve "Buldozierist" (p.sh. vetëm 3 në vend të 6), kjo mangësi është ekskluzivisht formale dhe teknike, jo substanciale:

Ne kemi aftësi profesionale të certifikuara për të gjitha makineritë e grupit "Buldozierist" (neni 8 i Urdhrit 200/2019).

Ne kemi punonjës realë të caktuar për secilin profil specifik (sipas listës së DST-së). Ne kemi garanci kontraktuale që këta punonjës do të jenë të disponueshëm gjatë gjithë kohës së punimeve. Një diferencë në numrin e certifikatave të njëjtë DAP nuk krijon asnjë pengesë reale për ekzekutimin e kontratës - prandaj nuk mund të konsiderohet si mospërmbushje thelbësore sipas nenit 82.5 të Ligjit 162/2020. Për këtë arsye, ne konsiderojmë se neni 75 i Ligjit Nr. 162/2020 duhej të ishte aplikuar para se të merrej vendimi i skualifikimit:

Autoriteti Kontraktues kishte të drejtën dhe detyrën të na kërkonte sqarim plotësues për mënyrën se si do t'i caktonim punonjësit me DAP "buldozierist" ndaj profileve të shumta (p.sh. Duke paraqitur një plan të thjeshtë caktimi ose duke plotësuar me një DAP shtesë nëse do të konsiderohej e domosdoshme).

Ky sqarim do të ishte lehtësuar plotësisht nga ana jonë brenda afateve të arsyeshme, pa ndryshuar thelbin e ofertës sonë.

Duke kaluar direkt në skualifikim pa kërkuar sqarim, Autoriteti Kontraktues ka shkelur parimin e proporcionalitetit (neni 2 i Ligjit 162/2020) dhe ka kufizuar padrejtësisht konkurrencën, gjë që bie ndesh me praktikën e vazhdueshme të Komisionit të Prokurimit Publik (p.sh. Vendimi KPP Nr. 1090/7 prot., ku është theksuar nevoja për sqarime në çështje teknike të personelit para masës ekstreme të skualifikimit).

*Përfundimisht, ne kërkojmë:*

- 1. Shfuqizimin e vendimit të skualifikimit si të padrejtë dhe të pamotivuar mjaftueshëm.*
- 2. Urdhërimin e Autoritetit Kontraktues për të na kërkuar sqarim plotësues sipas nenit 75 të Ligjit 162/2020, në mënyrë që të vlerësohet realisht aftësia jonë për të përmbushur kërkesat e personelit mbështetës.*
- 3. Rivlerësimin e ofertës sonë pas këtij sqarimi, në përputhje me parimin e barazisë dhe konkurrencës së lirë. Ky është qëndrimi ynë i bazuar në ligj, në dokumentacionin e paraqitur dhe në logjikën e ekzekutimit real të punimeve. Ne jemi plotësisht të gatshëm të bashkëpunojmë për sqarimin e cdo pike që mund të ketë mbetur e paqartë.*

II.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 551/1 datë 23.02.2026, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik kundërshton nëpërmjetë ankesës nr. 551/2026, datë 23.02.2026.

II.10. Me shkresën nr. 1555 prot, datë 02.03.2026, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 551/2 prot, datë 02.03.2026 dërguar nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike si dhe shkresën nr. 1559 prot, datë 02.03.2026, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 551/3 prot, datë 05.03.2026 dërguar nëpërmjetë shërbimit postar autoriteti kontraktor ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës nr. 85, datë 02.03.2026, nga verifikimi i të cilit rezulton se ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Udha” SHPK me argumentat si më poshtë vijon:

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesës, pasi u njoh me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Udha” sh.p.k, lidhur me vendimin e Komisionit te Vleresimit te Ofertave per skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me objekt “Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njesise Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë”, ka shqyrtuar ne menyre te plotë dhe te gjithanshme dokumentacionin e procedurës së prokurimit, Dokumentet Standarde te Tenderit, aktet e vlerësimit dhe arsyetimin e KVO-se, pretendimet e operatorit ekonomik te parashtruara në ankesë, si dhe bazen ligjore perkatese dhe konstaton si më poshte vijon:*

*Operatori ekonomik “Udha” sh.p.k. ne ankesen e paraqitur parashtron se kriteri teknik i percaktuar ne piken 2.3.7 te Dokumenteve Standarde te Tenderit per disponimin e “Kamionçines nën 3.5 ton” eshte interpretuar gabimisht nga Komisioni i Vlerësimit te Ofertave, duke argumentuar se mjeti i deklaruar prej tij e permbush këtë kriter per shkak te kapacitetit mbajtes real, pavaresisht se masa maksimale e autorizuar e mjetit tejkalon kufirin 3.5 ton.*

*Së pari, kriteri teknik i percaktuar ne Dokumentet Standarde te Tenderit, konkretisht ne piken 2.3.7, per disponimin e “Kamionçines nën 3.5 ton”, eshte vendosur që ne fazen e hartimit dhe publikimit të dokumenteve të procedurës, ne mënyre te barabarte dhe te njejte per te gjithë*

operatores ekonomikë. Ky kriter është formuluar duke përdorur terminologji standarde ligjore dhe teknike dhe nuk përmban paqartësi për t'u keqinterpretuar nga KVO.

Kriteri "Kamionçine nën 3.5 ton" ka kuptim të qartë dhe të konsoliduar në legjislacionin shqiptar, nuk përben nocion të paqartë apo të dykuptimshme dhe i referohet masës maksimale të autorizuar të mjetit (MMA), e cila përcakton edhe kategorinë e tij sipas Ligjit nr. 8378/1998, Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë. Ky kufi ligjor dallon mjetet e kategorisë N1 (mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3.5 ton) nga ato të kategorisë N2 (mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3.5 ton dhe jo më të madhe se 12 ton) dhe nuk lidhet me kapacitetin mbajtes apo me diferencën ndërmjet masës maksimale dhe masës bosh. Ky klasifikim ka karakter detyrues dhe nuk varet nga interpretimi i operatorëve ekonomikë.

Nga dokumentacioni provues i paragjitur nga vete operatori ekonomik "Udha" sh.p.k rezulton se mjeti me targë AA 251 HE në lejen e qarkullimit nr. PED0112115 pika 23 ka masë maksimale të autorizuar (MMA) 7490 kg, i përket kategorisë N2 (Kamion) dhe identifikohet si i tillë edhe në çertifikatën e kontrollit teknik (N2 Kamion) dhe në çertifikatën e pronësive (E-7 kamion me vinc i montuar). Këto të dhëna zyrtare dëshmojnë qartësisht se mjeti tejkalon kufirin 3.5 ton dhe për rrjedhojë, nuk përmbush kriterin e kërkuar "Kamionçine nën 3.5 ton".

Interpretimi i operatorit se kriteri duhet të vlerësohet mbi bazën e kapacitetit mbajtes është i pambeshtetur në legjislacion dhe në kundërshtim me kategorizimin ligjor të mjeteve. Autoriteti Kontraktor (Komisioni i Vlerësimit të Ofertave) është i detyruar të mbeshtetet në të dhënat zyrtare të dokumenteve të mjetit dhe jo në interpretime alternative.

Ky kategorizim ka karakter detyrues dhe është i zbatueshëm në të gjitha rastet ku përdoren nocione të tilla në dokumente administrative apo kontraktore. Argumenti i operatorit ekonomik nuk mbeshtetet në asnjë dispozitë ligjore, bie ndesh me kuptimin standard dhe të unifikuar të kategorive të mjeteve sipas Kodit Rrugor dhe pranimi nga ana e Autoritetit Kontraktor (Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) do të krijonte pasiguri juridike dhe trajtim të pabarabartë ndërmjet operatorëve ekonomikë. Pretendimi i operatorit për standard të dyfishtë në skualifikim, nuk qëndron, pasi faza e parë përfaqëson vetëdeklarim të operatorit dhe në fazën e shqyrtimit të dokumentacionit provues nga KVO ka rezultuar që mjeti i deklaruar si Kamioncinë nën 3.5 ton, faktikisht është kamion 7.49 ton, çka e bën të ligjshëm dhe të drejtë skualifikimin.

Komisioni vlerëson se interpretimi dhe vendimi i KVO-se është i drejtë dhe në përputhje me ligjin, pasi garanton trajtim të barabartë dhe standard objektiv për të gjithë operatorët ekonomikë. Për rrjedhojë, pretendimi i operatorit në këtë pikë konsiderohet i pabazuar dhe i pambeshtetur në prova.

Operatori ekonomik "Udha" sh.p.k në ankesën e paraqitur parashtron se mjeti "Autobot Uji" i deklaruar prej tij, ndonëse në lejen e qarkullimit figuron me destinacion "transport mallrash të rrezikshëm", përdoret realisht si autobot uji dhe përmbush kërkesat, pasi nuk është e ndaluar shprehimisht në DST.

*Së dyti, lidhur me pretendimin për skualifikim jo të drejtë për mjetin “Autobot uji”, Komisioni vlerëson se procedurat e prokurimit publik bazohen në dokumentacion zyrtar të verifikueshem dhe jo në deklarime apo përdorime faktike të paformalizuara. Destinacioni i përdorimit të mjetit, i pasqyruar në lejen e qarkullimit, përbën element thelbësor ligjor.*

*Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “UDHA” sh.p.k, për mjetin Autobot uji me targë AA 687 DR, sipas lejes së qarkullimit nr.PEF00361925, (J.1)-Destinacioni dhe përdorimi i mjetit, rezulton automjeti për transport mallrash të rrezikshëm, i cili nga natyra dhe destinacioni i përdorimit nuk përputhet me mjetin e kërkuar dhe të deklaruar për këtë procedurë. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion tjetër ku të vertetohet rihomologim, akt ndryshimi destinacioni apo autorizim që provon përdorimin si autobot uji.*

*Në DST kërkohet disponimi i një mjeti konkret “Autobot Uji” i cili duhet të provohet me dokumentacion zyrtar. Autoriteti Kontraktor (KVO) nuk ka kompetencë të vlerësojë përdorime faktike të paformalizuara. Sipas legjislacionit shqiptar, çdo ndryshim në destinacionin e përdorimit të mjetit duhet të reflektohet në lejen e qarkullimit.*

*Në mungesë të një akti administrativ që provon ndryshimin e destinacionit të mjetit, KVO ka vepruar në përputhje me ligjin duke mos e konsideruar këtë mjet si autobot uji dhe pretendimi i operatorit ekonomik është subjektiv, i pabazuar dhe i pambështetur në prova.*

*Operatori ekonomik “Udha” sh.p.k në ankesën e paraqitur parashtron se mungesa e manovratorëve me dëshmi aftësie profesionale Buldozierist përben mangësi formale, nuk është mospërbushje thelbësore dhe se KVO duhej të aplikonte nenin nr. 75 të Ligjit nr. 162/2020 dhe operatori ekonomik të plotësonte DAP shtese.*

*Së treti, Komisioni vlerëson se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3-6 (a) të Dokumentave Standarde të Tenderit kërkon në mënyrë të shprehur dhe të detajuar disponimin e një numri minimal të caktuar manovratorësh 8 (tetë) manovratorë sipas profileve përkatëse të përcaktuara në DST dhe urdhërit nr.200 datë 16.05.2019, të pajisur me dëshmi të vlefshme të aftësisë profesionale dhe kontratë të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit. Ky kriter përben kusht kualifikimi thelbësor dhe jo element formal.*

*Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3-6 (a) të Dokumentave Standarde të Tenderit- Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 8 (tetë) punonjës manovratorë të mjeteve/makinerve të renda specifikisht sipas profileve të mëposhtme:*

- Manovrator asfaltshtruese → 1 manovrator
- Manovrator eskavatori → 1 manovrator
- Manovrator grejderi → 1 manovrator
- Manovrator rruli vibrues → 2 manovrator,
- Manovrator ruli asfalti → 1 manovrator,
- Manovrator makinerie skarifikimi asfalti → 1 manovrator,

- *Manovrator Autovinçi* → *I manovrator*

*Për cdo profil punonjesi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates), dëshmite e aftësisë profesionale (te vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse sipas modaliteteve te urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019. Referuar urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019 të MIE “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike te kandidateve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit te makinerive të ndërtimit” neni nr.8, makineritë e rënda te ndërtimit dhe emërtimet behen sipas Dëshmisë se Aftësisë Profesionale (DAP) të cilat ndahen si më poshtë:*

- 1. Manovrator me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP) Eskavatorist - eskavator germimi e ngarkimi dherash, te gjitha llojet si dhe fadromat te gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhire).*
- 2. Manovrator Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP) Buldozierist - buldozier germimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje derash apo shpim toke: te gjithë llojet e traktoreve me thike (ruspe) ose qe terheqin skreper, grejer apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, kreperet, grejderet dhe niveluesit kur jane vetelevizes, te gjithë llojet e traktorerve, me paisje shtese per ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj.*

*Manovrator Dëshmi te Aftësisë Profesionale (DAP) Automakinist - Automjete për perdorim të vecantë (APV), makineri ndërtimi mbi bazë automjeti-autovinca, autobetonjere, autopompa betoni, autobitumatrice, autosonda, autotokmak.*

*Sipas urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019, neni 8 dhe kërkesa e DST-së pika 2.3-6 (a), kërkohen specifikisht manovratorët si më poshtë:*

- *1 (një) manovrator me dëshmi te aftësive profesionale për Eskavatorist (Manovrator eskavatori)*
- *6 (gjashtë) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist (1 Manovrator asfaltoshtruese; 1 Manovrator grejderi; 2 Manovrator ruli vibrues; 1 Manovrator ruli asfalti; 1 Manovrator makinerie skarifikimi asfalti).*
- *1 (një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale per Automakinist (Manovrator Autovinçi).*

*Operatori ekonomik “Udha” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin provues per punonjes manovratorë të mjeteve/makinerive te rënda sipas dëshmime të aftësisë profesionale si më poshtë:*

- *1 (një) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Eskavatorist.*
- *3 (tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale per Buldozierist.*
- *4 (kater) manovratorë me dëshmi te aftësive profesionale per Automakinist.*

*Nga ana e operatori ekonomik ankimues subjektit “Udha” sh.p.k janë paraqitur kontratat e punës dhe dëshmi të aftësive profesionale si më poshtë:*

- 1-E. S, manovrador me dëshmi te aftesive profesionale per Eskavatorist.
- 2-F. H., manovrador me dëshmi te aftësive profesionale për Buldozierist.
- 3-L. Xh, manovrador me dëshmi te aftesive profesionale per Buldozierist.
- 4-V. K, manovrador me dëshmi te aftesive profesionale per Buldozierist.
- 5-G. Ç, manovrador me dëshmi te aftesive profesionale per Automakinist.
- 6-N. B, manovrador me dëshmi të aftësive profesionale për Automakinist.
- 7-Sh. Ç, manovrador me dëshmi të aftësive profesionale per Automakinist.
- 8-E. P, manovrador me dëshmi te aftesive profesionale për Automakinist.

*Për rrjedhojë, mungojnë 3 (tre) manovradorë me dëshmi te aftësive profesionale per Buldozierist, ndërkohë që kërkesa e DST përcakton shprehimisht nevojën per 6 (gjashtë) te tillë.*

*Në kushtet ku DST vendos numrin minimal të manovradorëve, profil te percaktuar dhe dokument provues (DAP për profilin përkatës), atëherë kemi një kriter objektiv. Kjo nuk është mangësi formale por është thelb i aftësisë teknike profesionale per zbatimin e kontratës.*

*Fakti qe operatori ekonomik “Udha” sh.p.k në dokumentacionin e paraqitur ka provuar vetëm 3 (tre) manovradorë me dëshmi te aftesive profesionale për Buldozierist, nga 6 (gjashte) manovradorë me dëshmi te aftësive profesionale për Buldozierist te kërkuar, do të thote se mungon gjysma e kapacitetit minimal të kërkuar per ate profil.*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, gjykon se profilet e manovradorëve sipas DST dhe urdherit nr.200/2019 nuk janë thjeshte emërtime por kategori certifikimi (DAP), dhe mungesa e 3(tre) prej tyre perbën mospermbushje thelbësore të kriterit te kualifikimit. Pretendimi nga ana e operatorit është subjektiv dhe i pa bazuar në legjislacion.*

*Në këto kushte me qellim përmbushjen e kërkesave të vecanta për kualifikim në zbatim të kësaj procedure nuk është plotësuar një nga kushtet thelbësore sipas kërkesave të nenit 82.5 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, dokumentacioni i paraqitur është në kundërshtim 2.3.6 (a) Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik dhe Komisioni vlerëson se interpretimi dhe vendimi i KVO-së është i drejtë, i ligjshëm, i argumentuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me Dokumentat Standarde të Tenderit, pasi garanton trajtim të barabartë dhe standard objektiv për të gjithë operatorët ekonomikë. Për rrjedhojë, pretendimi i operatorit në këtë pikë konsiderohet i pa bazuar.*

*Së katërti, për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik, lidhur me zbatimin e nenit nr.75 te Ligjit nr. 162/2020, Komisioni vlerëson se ky nen nuk mund të aplikohet në këtë rast, pasi nuk kemi paqartësi dokumentare, por kemi mungesë reale dhe te verifikueshme te 3 (tre) manovradorë me dëshmi te aftesive profesionale për Buldozierist. Neni nr.75 i Ligjit nr. 162/2020 nuk mund të aplikohet për te krijuar kapacitete qe nuk ekzistonin ne oferte. Plotesimi kesaj mungese, sic pretendon operatori ekonomik, pas afatit te ofertimit, do te sillte ndryshim kane permbushur kriterin qe ne fazen e ofertimit.*

*Pretendimi i operatorit ekonomik se një DAP per Buldozierist, mbulon disa makineri te grupit dhe se interpretimi i AK shton kërkesa te paqarta, eshte ne kundërshtim me Dokumentat standarse te Tenderit dhe urdhërin nr.200/2019. Në fazën e vlerësimit zbatohet strikt DST-ja dhe jo interpretime alternative, gjithashtu DST-ja nuk ka parashikuar këtë fleksibilitet qe operatori ekonomik pretendon, dhe KVO nuk ka të drejte te devijojë nga kriteret qe janë shpallur.*

*Gjithashtu Komisioni i Shqyrtimit të Ankeses, pas pretendimit të operatorit ekonomik, konstaton dhe sqaron se Komisioni i Vlerësimit te Ofertes në asnjë moment dhe ne asnje pjese te arsytimit te skualifikimit nuk ka konsideruar si shkak skualifikimi formen e sigurimit te personelit permes kontratave të qirase per manovratorët dhe te gjithë manovratorët e paraqitur nga operatori ekonomik janë konsideruar te vlefshëm nga pikëpamja numerike. Përkundrazi manovratorët e siguruar me kontratë qiraje janë konsideruar te vlefshëm. Mospermbushja e këtij kriteri nuk lidhet me numrin e pergjithshëm te manovratorëve, por me mungesën e numrit minimal te manovratorëve me deshmi të aftësive profesionale specifikisht per Buldozierist.*

*Komisioni vlereson se interpretimi dhe vendimi i KVO-se eshte i drejte dhe në përputhje me ligjin, pasi garanton trajtim te barabarte dhe standard objektiv per te gjithë operatorët ekonomike. Per rrjedhoje, pretendimi i operatorit në kuite pikë konsiderohet i pabazuar dhe i pambeshtetur në prova.*

*Operatori ekonomik “Udha” sh.p.k ne ankesën e paraqitur parashtron se Autoriteti Kontraktor (KVO) ka bërë skualifikim ne kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe ka perdorur standard te dyfishte duke e kualifikuar dhe më pas skualifikuar.*

*Se pesti, nga shqyrtimi i dokumentacionit te administruar nga KVO dhe pasqyrimeve ne sistem, rezulton se pretendimi i operatorit ekonomik eshte i pavertete, pasi eshte lehtesisht i verifikueshëm ne sistemin SPE se vlerësimi eshte kryer vetem me date 11.02.2026, per rrjedhoje pretendimi se operatori eshtë vlerësuar i kualifikuar me date 02.02.2026 nuk qendron ne aspektin fizik dhe procedural dhe bie ndesh me dokumentacionin administriv te procedures.*

*Së fundmi, në kushtet kur kriteri teknik i percaktuar ne pikën 2.3.7 dhe 2.3-6 (a) të Dokumenteve Standarde te Tenderit nuk eshtë permbushur, Komisioni i Vlerësimit te Ofertave ka vepruar ne përputhje me nenin 82, pika 5, të Ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285/2021, duke kryer skualifikimin si një veprim te detyrueshëm dhe jo diskrecional.*

*Procedura eshte kryer në përputhje te neneve 90 e vijues të Ligjit nr 162/2020 “Per Prokurimit Publik” dhe neneve 80 e vijues të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”. Gjithashtu anulimi i procedures nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Krujë eshte kryer, sipas ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin public” neni 98, Anulimi i nje procedure prokurimi, 1 (b) Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit ne rastet kur: b) ne procedurat me një faze nuk eshtë dorëzuar asnje ofertë e pershtatshme, si dhe në raport me nenin 64.4 te VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e*

*rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili parashikon se autoriteti kontraktor mund të anulohet një procedurë prokurimi të llojit marrëveshjes kuadër ku jo gjitha kushtet janë përcaktuar (me rihapje konkurimi).*

*Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon që vendimi i Autoritetit Kontraktor (Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Udha” sh.p.k është i drejtë, i ligjshëm, i argumentuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me Dokumentat Standarde të Tenderit.*

*Në këto kushte në përfundim të arsytimit të mësipërm Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës i caktuar pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Krujë me urdhërin nr.57 datë 23.02.2026 në mbështetje të nenit 114.3.c të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 102.1.c të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

#### *Vendosi*

*a) Të refuzojë ankesën e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik, “Udha” sh.p.k, si të pambështetur në ligj dhe prova.*

*b) Lënien në fuqi të vendimit të KVO për skualifikimin e ofertës së subjektit ankimues pasi nuk përmbush kërkesat e DST respektive.*

*c) Ky vendim mbahet gjithsej në 4(katër) kopje.*

*d) Ngarkohen për komunikimin e këtij vendimi Personi Përgjegjës për Prokurimin sipas rregullave të Prokurimit Publik.*

II.11. Me qëllim shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 551/4 prot., datë 06.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor që të dërgojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik ankimues “Udha” SHPK, në lidhje me vërtetueshmërinë e përmbushjes së ofertës dhe deklarimeve në shtojcën 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sikurse përcaktohet në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 të VKM 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

II.12. Me shkresën nr. 1794/1 prot, datë 10.03.2026, me objekt “Dërgim informacioni”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 551/5 prot., datë 12.03.2026” autoriteti kontraktor Bashkia Krujë ka dërguar informacion dhe dokumentacion gjithësej 374 faqe në zbatim të shkresës nr. 551/4 prot, datë 06.03.2026 të Komisionit Prokurimit Publik.

II.13. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezultoi se në datën 12.12.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH),

përkatësisht:

14. BOE “RSM Construction” dshh & “RSM Company” SHPK & “Biba X” SHPK	128,458,606	lekë	skualifikuar
15. “Shpresa AI” SHPK	146,565,622.63	lekë	kualifikuar
16. “Shëndelli” SHPK	149,380,147	lekë	kualifikuar
17. BOE “BE-IS” SHPK & “Ergi” SHPK	155,445,660	lekë	kualifikuar
18. “Curri” SHPK	155,670,050.13	lekë	kualifikuar
19. BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK	160,767,592.85	lekë	kualifikuar
20. BOE “Makareshi” SHPK & “B 93 II” SHPK & “Beqiri” SHPK	161,286,212	lekë	skualifikuar
21. “Udha” SHPK	161,928,268.14	lekë	kualifikuar
22. “Pepa Group” SHPK	162,033,632.72	lekë	kualifikuar
23. “Ndregjoni” SHPK	164,688,981.59	lekë	kualifikuar
24. BOE “Kegli Duri” SHPK & “Varaku E” SHPK & “LTE Construction” SHPK	165,895,056.86	lekë	skualifikuar
25. “Bami Holding” SHPK	172,235,914.02	lekë	kualifikuar
26. BOE “Almo Konstruksion” SHPK & “K. Turja” SHPK	177,248,275	lekë	kualifikuar

II.14. Në datën 15.12.2025, nëpërmjetë sistemit të prokurimeve elektronike nga rubrika kërkesa autoriteti kontraktor i është drejtuar operatorit ekonomik “Bami Holding” SHPK, si më poshtë vijon:

*Krujë më 15.12.2025*

*Lënda: Ftesë për paraqitje dokumentacioni provues të ofertës.*

*Objekti i Prokurimit: “Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë.”*

*Drejtuar: “BAMI HOLDING” sh.p.k*

*Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se subjekti “BAMI HOLDING” sh.p.k, me nr. NIPT J94416206R, dhe adresë Fushë-Krujë, Kamas dhe zyra qendrore me adresë Rr. “Durrësit” pallati mbrapa Ring Center Kati I, Tiranë, Albania 1001, me administrator Z.Gezim Marku, se oferta e paraqitur me vlerë totale 172.235.914,02 (njëqind e shtatëdhjetë e dy million e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e katërmbëdhjetë presje zero dy) lekë pa t.v.sh /totali i pikëve të marra [nuk ka vleresim me pikë ose sipas rastit kur ka vleresim me pikë] është identifikuar si Oferta e suksesshme. Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Krujë , Sheshi Mustafa Merlika (Kruja ), Kati i II Zyra e Prokurimeve Publike, dokumentat provuese të ofertës së tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi, në SPE.*

*Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi në përputhje me kërkesat e nenit , 76.3.ë, 82.5 të Ligjit nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë ose nuk dorëzoni (dokumentacionin provues të ofertës), brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.*

II.15. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 11.02.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “RSM Construction” dshh & “RSM Company” SHPK & “Biba X” SHPK	128,458,606	lekë	skualifikuar
2. “Shpresa AI” SHPK	146,565,622.63	lekë	skualifikuar
3. “Shëndelli” SHPK	149,380,147	lekë	skualifikuar
4. BOE “BE-IS” SHPK & “Ergi” SHPK	155,445,660	lekë	skualifikuar
5. “Curri” SHPK	155,670,050.13	lekë	skualifikuar
6. BOE “Lis Konstruksion” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK	160,767,592.85	lekë	skualifikuar
7. BOE “Makreshi” SHPK & “B 93 II” SHPK & “Beqiri” SHPK	161,286,212	lekë	skualifikuar
8. “Udha” SHPK	161,928,268.14	lekë	skualifikuar
9. “Pepa Group” SHPK	162,033,632.72	lekë	skualifikuar
10. “Ndregjoni” SHPK	164,688,981.59	lekë	skualifikuar
11. BOE “Kegli Duri” SHPK & “Varaku E” SHPK & “LTE Construction” SHPK	165,895,056.86	lekë	skualifikuar
12. “Bami Holding” SHPK	172,235,914.02	lekë	skualifikuar
13. BOE “Almo Konstruksion” SHPK & “K. Turja” SHPK	177,248,275	lekë	skualifikuar

II.16. Në datën 11.02.2026, operatori ekonomik “Bami Holding” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

*Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik “Bami Holding” sh.p.k, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se: Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3.7 të Dokumentave Standarde të Tenderit, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në*

*dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik që nevojiten në ekzekutimin e kontratës.*

*Për mjetin me targë KR7049A, të deklaruar kamionçinë nën 3.5 ton, referuar dokumentacionit provues, në lejen e qarkullimit me nr.DRF0307720 pika 23.Masa maksimale e autorizuar është 5990 kg dhe kodi i karrocërisë F3-Kamion. Gjithashtu, në çertifikatën e kontrollit teknik mjeti i përket kategorisë N2 (Kamion) dhe në çertifikatën e pronësisë së mjetit është F3-Kamion.*

*Nga këto të dhëna rezulton se mjeti tejkalon tonazhin e kërkuar, duke mos përmbushur kriterin 2.3.7 për “Kamioncinë nën 3.5 ton” i cili sipas ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” neni 47, pika 2 (c) Kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3.5 ton ndërsa N2 (Kamion): mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë me të madhe se 3.5 ton dhe jo me të madhe se 12 ton, si dhe neni 54 pika 1(c).*

*Për rrjedhojë, kërkesa e kriterit 2.3.7 të Dokumentave Standarde të Tenderit për kamionçinë nën 3.5 ton, nuk konsiderohet e plotësuar. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Bami Holding”sh.p.k është në kundërshtim me pikën 2.3.7 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës dhe përbën kusht për skualifikim. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesave të nenit 82.5 te Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe neni 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

II.17. Në datën 16.02.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim anulimit në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.18. Në datën 23.02.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2026/6358 dhe me numër 564/2026 prot., datë 23.02.2026 e operatorit ekonomik “Bami Holding” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “’Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë”, me fond limit 197’903’543 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e skualifikimit të operatorit ekonomik “Bami Holding” SHPK me përmbajtje si mëposhtë vijon:

*Pasi u njohëm me arsyet e skualifikimit nga ana e Autoritetit Kontraktor theksojmë se arsyeja e përmendur për skualifikim është e pa bazuar në dokumentat standarte të tenderit të hartuara nga vetë Autoriteti Kontraktor.*

*Më saktësisht në dokumentat standarte të tenderit Shtojca 7 - Formular i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, Pika 2 - Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Nenpika 2.3 - Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Nenpika 2.3.7 - dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratës.*

*Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera. Nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar mjete i poshtëshënuar: kamionáinë nën 3.5 ton. Copë 2 pronësi ose me qera.*

*Sic shihet në kërkesën e dokumentave të tenderit nuk është bërë asnjë kërkesë specifike që pesha nën 3.5 ton është masa maksimale e autorizuar apo kapaciteti mbajtës i mjetit apo kërkesa referuar kategorive të mjeteve sipas kodit rrugor. Nese Autoriteti Kontraktor do ta kishte qartësuar kërkesen për këto mjet kaq specifik shoqëria jone ka mjete të tjera që i plotësojnë dhe këto kërkesa nese do të ishin të qartësuara nga ana Autoritetit Kontraktor.*

*Ne i kemi referuar praktikës së përhershme që kërkesat për kapacitet janë kapacitetet mbajtëse të mjetit pasi ato janë të rëndësishme dhe të nevojshme për kryerjen e punimeve, ndaj kemi paraqitur mjete kamionáina me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton. Për shembull: BAMI HOLDING Shpk ka marrë pjesë dhe në procedurën e tenderimit me të dhëna si : Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF-67706-11-04-2025, Objekti i Kontrates/Draft Marreveshjes Kuader: ësisistemim Asfaltim i Rrugeve në territorin e Njesise Administrative Thumane , Bashkia Krujë ë, Fondi limit/vlera e pritshme totale e kontratave të lidhura gjatë vlefshmerisë së marreveshjes kuader : 102,170,900 (njqind e dymilion e njqind e shtatedhjqete mjqe e nentjqind) lekë pa tvsh, Data: 20.11.2025 (d/m/v) ora 10:00.*

*Ne këto procedure tenderimi nga Autoriteti Kontraktor ka qene po e njqjta kerkese për të njqjtin lloj mjeti kamionáinë nën 3.5 ton dhe nga ana jone eshte paraqitur nje mjet me të njqjtat karakteristika për përmbushjen e kesaj kerkese dhe nga ana e KVO të Autoritetit Kontraktor eshte konsideruar i përmbushur duke na vleresuar si operator i suksesshem. Ky eshte nje vleresim me dy standarte i bere nga i njqjti Autoritet Kontraktor ku nje here na vlereson si te suksesshem dhe nje here na skualifikon për paraqitjen e nje mjeti me të njqjtat karakteristika për përmbushjen e të njqjtes kerkese.*

*Per sa me lart ne kemi shumë të bindur se mjeti kamioncine me targa KR7049A që ne kemi paraqitur në përmbushje të kriterit të kërkuar kamioncinë nën 3.5 ton. Është në përputhje të plotë dhe e plotëson kërkesën e paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit. Kjo dëshmohet me dokumentacionin e vënë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor dhe nga foto e paraqitur e mjetit ku vërehet shumë qartë dhe lehtësisht se mjeti i deklaruar është një kamionáinë me sipas Lejes Qarkullimit të mjetit masa maksimale autorizuar 5990 kg dhe masa e mjetit bosh 3420 kg diferenca mes tyre që është kapacitet mbajtës është 2570 kg pra nën 3.5 ton. Në këtë situatë theksojmë se skualifikimi i bërë nga ana e Autoritetit Kontraktor për shoqërinë tonë në këtë procedurë tenderimi është i pa drejte dhe jo në përputhje me ligjin nr.162/2020 Për Prokurimin Publik me ndryshimet VKM nr.285 datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik me ndryshimet, jo në përputhje me Dokumentat Standarte të Tenderit. Kërkojme nga Autoriteti Kontraktor që të bëjë rivleresim të kesaj procedure tenderi, të ndryshojë vleresimin e bere dhe të bëjë kualifikimin e shoqërisë BAMI HOLDING Shpk si operator ekonomik i suksesshem.*

*Bashkengjitur mund të gjeni dokumentat e mjetit me targe KR7049A.*

II.19. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 564/1 datë 24.02.2026, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik kundërshton nëpërmjetë ankesës nr. 564/2026, datë 23.02.2026.

II.20. Me shkresën nr. 1556 prot, datë 02.03.2026, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 564/2 prot, datë 02.03.2026 dërguar nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike si dhe shkresën nr. 1560 prot, datë 02.03.2026, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 564/3 prot, datë 05.03.2026 dërguar nëpërmjetë shërbimit postar autoriteti kontraktor ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës nr. 86, datë 02.03.2026, nga verifikimi i të cilit rezulton se ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Bami Holding” SHPK me argumentat si më poshtë vijon:

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankeses, pasi u njoh me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Bami Holding” sh.p.k, lidhur me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me objekt “Sistemim Asfaltim i Rrugeve në territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë”, ka shqyrtuar në mënyrë të plote dhe të gjithanshme dokumentacionin e procedurës së prokurimit, Dokumentet Standarde të Tenderit, aktet e vlerësimit dhe arsyetimin e KVO-se, pretendimet e operatorit ekonomik të parashtruara në ankesë, si dhe bazën ligjore perkatëse dhe konstaton si më poshtë vijon:*

*Operatori ekonomik “Bami Holding” sh.p.k në ankesën e paraqitur parashtron se kriteri teknik i përcaktuar në pikën 2.3.7 të Dokumenteve Standarde të Tenderit për disponimin e “Kamionçines nën 3.5 ton” nuk është i qartë dhe specifik duke argumentuar se Autoriteti Kontraktor duhej ta kishte specifikuar me tej përmbajtjen e tij. Sipas ankesës së operatorit ekonomik, mjeti i deklaruar e përmbush kriterin “Kamionçine nën 3.5 ton”, pasi kapaciteti mbajtes i mjetit (diferenca ndermjet mases maksimale të autorizuar dhe mases bosh) është nën 3.5 ton. Gjithashtu, operatori parashtron se në një procedure tjetër të mëparshme është kualifikuar për të njejtin kriter, çka sipas tij perben aplikim të dy standardeve të ndryshme dhe cënim të barazisë dhe ligjshmerisë.*

*Së pari, kriteri teknik i përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht në pikën 2.3.7, për disponimin e “Kamionçinës nën 3.5 ton”, është vendosur që në fazën e hartimit dhe publikimit të dokumenteve të procedurës, në mënyrë të barabartë dhe të njejte për të gjithë operatorët ekonomikë. Ky kriter është formuluar duke përdorur terminologji standarde ligjore dhe teknike dhe nuk përmban paqartësi që të kërkojnë sqarim shtesë nga Autoriteti Kontraktor.*

*Autoriteti Kontraktor nuk ka detyrim ligjor të ripërkufizojë apo të shpjegojë nocione të përcaktuara qartë nga legjislacioni në fuqi, ndërsa operatorët ekonomikë kanë përgjegjesinë për interpretimin korrekt të kriterëve dhe përzgjedhjen e mjeteve që përputhen plotësisht me to. Kriteri “Kamionçinë nën 3.5 ton” ka kuptim të qartë dhe të konsoliduar në legjislacionin*

shqiptar, nuk perben nocion të paqartë apo të dykuptimtë që kërkon sqarim shtesë dhe i referohet masës maksimale të autorizuar të mjetit (MMA), e cila percakton edhe kategorinë e tij sipas Ligjit nr. 8378/1998, Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë. Ky kufi ligjor dallon mjetet e kategorisë N1 (mjete të destinuar për transport mallrash dhe që kanë peshe maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3.5 ton) nga ato të kategorisë N2 (mjete të destinuar për transport mallrash dhe që kanë peshe maksimale me ngarkesë me të madhe se 3.5 ton dhe jo me të madhe se 12 ton) dhe nuk lidhet me kapacitetin mbajtës apo me diferencën ndërmjet masës maksimale dhe masës bosh.

Ky klasifikim ka karakter detyrues dhe nuk varet nga interpretimi i operatoreve ekonomike. Për rrjedhojë Autoriteti Kontraktor nuk ka detyrim ligjor të sqarojë më tej një kriter i cili buron drejtpërdrejtë nga një kategorizim ligjor dhe nuk mund të zëvendësojë kategorizim ligjor të mjetit me një interpretim të njeanshëm të operatorit.

Së dyti, nga dokumentacioni provues i paragjitur nga vetë operatori ekonomik “Bami Holding” sh.p.k rezulton se mjete me targë KR7049A në lejen e qarkullimit nr. DRF0307720 pika 23 ka masë maksimale të autorizuar (MMA) 5990 kg, i përket kategorisë N2 (Kamion) dhe identifikohet si i tillë edhe në çertifikatën e kontrollit teknik dhe në çertifikatën e pronësise. Këto të dhëna zyrtare dëshmojnë qartësisht se mjete tejkalon kufirin 3.5 ton dhe për rrjedhojë, nuk përmbush kriterin e kërkuar “Kamionçinë nën 3.5 ton”.

Interpretimi i operatorit se kriteri duhet të vlerësohet mbi bazën e kapacitetit mbajtës është i pambështetur në legjislacion dhe në kundërshtim me kategorizimin ligjor të mjeteve. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të mbështetet në të dhënat zyrtare të dokumenteve të mjetit dhe jo në interpretime alternative.

Ky kategorizim ka karakter detyrues dhe është i zbatueshëm në të gjitha rastet ku përdoren nocione të tilla në dokumente administrative apo kontraktore. Argumenti i operatorit ekonomik nuk mbështetet në asnjë dispozitë ligjore, bie ndesh me kuptimin standard dhe të unifikuar të kategorive të mjeteve sipas Kodit Rrugor dhe pranimi nga ana e Autoritetit Kontraktor (Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) do të krijonte pasiguri juridike dhe trajtim të pabarabartë ndërmjet operatoreve ekonomikë.

Së treti, pretendimi se Autoriteti Kontraktor ka aplikuar “dy standarde”, duke u mbështetur në një procedurë tjetër të meparshme, nuk qëndron. Çdo procedurë prokurimi vlerësohet nga një Komision i Veçantë i Vlerësimit të Ofertave (KVO), i ndryshëm për secilën procedurë, i cili ushtron kompetencat e tij në mënyrë autonome dhe vlerëson procedurën në bazë të dokumentacionit konkret të paraqitur. Vlerësimet e kryera nga KVO të ndryshme në procedurë të ndryshme nuk krijojnë precedent detyrues dhe nuk kushtëzojnë vlerësimin në një procedurë tjetër. Parimi i barazisë në prokurimin publik zbatohet brenda të njëjtes procedurë, nga e njëjta KVO, për të gjithë operatorët pjesëmarrës. Në procedurën objekt ankese “Sistemim-Asfaltim i rrugëve në Territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë”, me nr. REF-67572-11-03-2025, kriteri teknik është zbatuar në mënyrë të njëjtes dhe uniforme për të gjithë operatorët ekonomikë dhe nuk ka pasur trajtim selektiv apo diskriminues.

*Së fundmi, në kushtet kur kriteri teknik i percaktuar ne pikën 2.3.7 te Dokumenteve Standarde te Tenderit nuk është përmbushur, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vepruar ne përputhje me nenin 82, pika 5, të Ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenin 26, pika 6, te VKM nr. 285/2021, duke kryer skualifikimin si një veprim te detyrueshëm dhe jo diskrecional.*

*Procedura është kryer ne përputhje të neneve 90 e vijues të Ligjit nr 162/2020 “Per prokurimin Publik” dhe neneve 80 e vijues të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.*

*Gjithashtu anulimi i procedurës nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Krujë është kryer, sipas ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin public” neni 98, Anulimi i një procedure prokurimi, 1(b) Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit ne rastet kur: b) ne procedurat me një faze nuk është dorëzuar asnjë oferte e pershtatshme, si dhe ne raport me nenin 64.4 te VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar i cili parashikon se autoriteti kontraktor mund te anulojë nje procedure prokurimi te llojit marrëveshjes kuader ku jo gjitha kushtet jane percaktuar (me rihapje konkurimi).*

*Në perfundim, Komisioni i Shayrtimit të Ankesave gjykon qe vendimi i Autoritetit Kontraktor (Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) per skualifikimin e ofertes se operatorit ekonomik “Bami Holding” sh.p.k është i drejte, i ligjshëm, i argumentuar dhe ne përputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me Dokumentat Standarde të Tenderit.*

*Gjithashtu gjykon se kriteri teknik ka qenë i qartë dhe i ligjshem; mjeti i paraqitur nga operatori nuk e përmbush kete kriter; pretendimet per paqartesi dhe per aplikim te dy standardeve jane te pabazuara, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Bami Holding” sh.p.k është ne kundërshtim me pikën 2.3.7 Dëshmi per mjetet e pajisjet teknike, që ka ne dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten per ekzekutimin e kontrates, te Dokumentave Standarde te Tenderit.*

*Në këto kushte në perfundim të arsytimit te mësiperm Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses i caktuar pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Krujë me urdherin nr.60 date 23.02.2026 ne mbështetje te nenit 114.3.c te Ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik” dhe nenit 102.1.c te VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

#### *Vendosi*

*a) Të refuzojë ankesën e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik, “Bami Holding” sh.p.k, si të pambeshtetur ne ligj dhe prova.*

*b) Lënien ne fuqi të vendimit të KVO per skualifikimin e ofertes së subjektit ankimues pasi nuk përmbush kerkesat e DST respektive.*

*c) Ky vendim mbahet gjithsej ne 4 (katër) kopje.*

d) Ngarkohen per komunikimin e këtij vendimi Personi Pergjegjes per Prokurimin sipas Rregullave te Prokurimit Publik.

II.21. Me qëllim shqyrtimin e ankesën e operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 564/4 prot., datë 06.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor që të dërgojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoriteti kontraktor nga operatori ekonomik ankimues “*Bami Holding*” SHPK, në lidhje me vërtetueshmërinë e përmbushjes së ofertës dhe deklarimeve në shtojcën 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sikurse përcaktohet në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 të VKM 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

II.13. Me shkresën nr. 1795/1 prot, datë 10.03.2026, me objekt “Dërgim informacioni”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 564/5 prot., datë 12.03.2026” autoriteti kontraktor Bashkia Krujë ka dërguar informacion dhe dokumentacion gjithësej 1312 faqe në zbatim të shkresës nr. 564/4 prot, datë 06.03.2026 të Komisionit Prokurimit Publik.

II.15. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Udha*” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “*Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik “Udha” sh.p.k, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se: Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3.7 të Dokumentave Standarde të Tenderit-, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik që nevojiten në ekzekutimin e kontratës, Për mjetin me targë AA251HE, të deklaruar kamioncinë nën 3.5 ton, referuar dokumentacionit provues, në lejen e qarkullimit me nr.PED0112115 pika 23.Masa maksimale e autorizuar është 7490 kg. Gjithashtu, në certifikatën e kontrollit teknik mjeti i përket kategorisë N2 (Kamion) dhe në certifikatën e pronësisë së mjetit është E7-Kamion me vinq i montuar. Nga këto të dhëna rezulton se mjeti tejkalon tonazhin e kërkuar, duke mos përmbushur kriterin 2.3.7 për “Kamioncinë nën 3.5 ton” i cili sipas ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” neni 47, pika 2 (c) Kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3.5 ton ndërsa N2 (Kamion): mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë me të madhe se 3.5*

ton dhe jo me të madhe se 12 ton, si dhe neni 54 pika 1(c).”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të modifikuar pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, është parashikuar si vijon:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë.

- Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera.

<b>I. MAKINERI</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Pronësia</b>
Automjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton.	Copë	3	Pronësi ose me qera
Kamionçinë nën 3.5 ton.	Copë	2	Pronësi ose me qera
Eskavator.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshës i tonazhit të madh.	Copë	2	Pronësi ose me qera
Grejder.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Autobot uji.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul asfalti.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Makineri për skarifikim asfalti.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Autovinç	Copë	1	Pronësi ose me qera
<b>II. PAJISJE</b>			
Betonierë.	copë	1	Pronësi ose me qera
Matrapik.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Vibrator (betoni).	copë	1	Pronësi ose me qera
Jelekë fosforeshentë/uniforma pune.	copë	40	Pronësi ose me qera
Kallëp dërrase (armaturë).	m <sup>2</sup>	140	Pronësi ose me qera

Karroca dore.	copë	1	Pronësi ose me qera
Tabela rrugore (për punime në rrugë).	copë	4	Pronësi ose me qera
Kokore për punonjësit.	copë	40	Pronësi ose me qera
Kuti e ndihmës së shpejtë.	copë	1	Pronësi ose me qera

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jënë aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) *Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).*
- c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata perkatese noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 08.pika C (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohej dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).*

**Shenim-** *Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorëzoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.*

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe shkresës me nr. 1794/1 prot., datë 10.03.2026, protokolluar pranë KPP-së me nr. 551/5 prot., datë 12.03.2026 rezulton se operatori ekonomik “*Udha*” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “*Udha*” SHPK të nënshkruar dhe vulosur, ku në pjesën III Kriteret e Përzgjedhjes kualifikimit, pika D

Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ndër të tjera evidentohet se ka deklaruar Kamioncinë nën 3.5 ton mjetin me targë AA 251 HE, nr. Lejes së qarkullimit PED0112115, nr. Shasisë EDB67401315405274.

- Leje qarkullimi Nr. PED0112115, për mjetin me targë AA 251 HE.
- Certifikatë Pronësie e Mjetit Rrugor.
- Certifikatë nr. 22 datë 05.08.2025 Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, për mjetin AA 251 HE Mercedes Benz.
- Licencë nr. 03, datë 04.08.2025 Për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit.
- Foto e mjetit.
- Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore për mjetin me targë AA 251 HE.
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, nr. 9043671, datë 02.10.2025.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

III.1.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”.

III.1.8. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose
- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.9. Në nenin 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod, klasifikohen si vijon:

- a) mjete që lëvizin me forcën e krahut;
- b) mjete të tërhequra me kafshë;
- c) mjete me pedal;
- d) slita;
- e) ciklomotori;
- f) motomjete;
- g) automjete;
- h) trolejbusë;
- i) rimorkio;
- j) makina bujqësore;
- k) makina teknologjike;
- l) mjete rrugore të veçanta.

2. Mjete me motor dhe rimorkiot e tyre, sipas shkronjave “e”, “f”, “g”, “h”, “i” “j” dhe “l”, të pikës 1, të këtij neni, klasifikohen, gjithashtu, në bazë të kategorive ndërkombëtare si më poshtë:

a) - *Kategoria L1: mjete me dy rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h, fuqia maksimale nuk është më shumë se 4 kË në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L2: mjete me tri rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h; rendimenti maksimal neto i fuqisë nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L3: mjete me dy rrota, pa kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L4: mjete me dy rrota, me kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo*

*lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

*- Kategoria L5: mjete me tri rrota të përshtatura simetrikisht, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

*- Kategoria L6: mjete me katër rrota të lehta, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 350 kg, pa përfshirë masën e baterive në rastin e automjeteve elektrike, me shpejtësi maksimale të projektuar jo më të madhe se 45 km/h, cilindrata e motorit të mos i kalojë 50 cm<sup>3</sup> dhe rendimenti maksimal neto i të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme e të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

*- Kategoria L7: mjete me katër rrota të ndryshme nga L6, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 400 kg (550 kg për automjetet e synuara për transportimin e mallrave), pa përfshirë masën e baterive, në rastin e automjeteve elektrike, dhe fuqia maksimale neto e motorit e të cilave nuk është më shumë se 15 kË;*

*b) - kategoria M: mjete me motor të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë të paktën katër rrota;*

*- kategoria M1: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që nuk kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit;*

*- kategoria M2: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë deri 5 tonë;*

*- kategoria M3: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 tonë;*

*c) - kategoria N: mjete me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota;*

*- kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë;*

*- kategoria N2: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 12 tonë;*

*- kategoria N3: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë;*

*d) - kategoria O: rimorkiot (përfshirë edhe gjysmërimorkiot);*

*- kategoria O1: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0,75 tonë,*

*- kategoria O2: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0,75 tonë, por jo më të madhe se 3,5 tonë;*

*- kategoria O3: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë;*

*- kategoria O4: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë.*

*dh) - Kategoria T: traktorët me rrota;*

*- Kategoria T1: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me boshtin më të afërt te drejtuesi, që ka gjerësi minimale zinxhiri prej jo më pak se 1150 mm, me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 1 000 mm;*

*- Kategoria T2: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se*

40 km/h, me gjerësi minimale zinxhiri prej më pak se 1150 mm, e një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 600 mm;

- *Kategoria T3: traktorët e pajisur me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h dhe me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej jo më shumë se 600 kg;*

- *Kategoria T4: traktorët e pajisur me rrota për qëllime të veçanta, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria T5: traktorët e pajisur me rrota me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria C: traktorët me zinxhirë të pandërprerë;*

*Traktorët me zinxhirë të pandërprerë që shtyhen dhe drejtohen nga zinxhirë të pandërprerë dhe kategoritë e të cilëve, C1 deri C5, përcaktohen në analogji me kategoritë T1 deri T5.*

III.1.10. Në nenin 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. *Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar përmasat gabarite kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, kurse për normat konstruktive dhe sistemet e pajimit duhet të respektojnë dispozitat e nenit 105.*

2. *Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit.*

3. *Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar dispozitat e neneve 98, 106, 107, 110 dhe 111. Makinat teknologjike që, për kërkesa funksionale, i tejkalojnë përmasat gabarite kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, konsiderohen makina teknologjike jashtë norme dhe për to zbatohen normat e parashikuara në nenin 103, pika 8.*

4. *Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit.*

5. *Mënyrat e zbatimit të pikave 2 dhe 3, si dhe ato që kanë të bëjnë me modifikimet në emërtimin e mjeteve, përmbajtjen dhe karakteristikat e lejes së qarkullimit, janë përcaktuar me udhëzime të organeve të ministrisë përgjegjës për transportin.*

6. *Mënyrat për regjistrimin dhe targimin përcaktohen në akte të veçanta.*

7. *Cilido që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me të njëjtat sanksione të parashikuara për të njëjtat shkelje të kryera me makinat bujqësore.*

III.1.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të

detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.12. Konkretisht, referuar kriterit në pikën 2.3.7 për disponimin e mjeteve që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, konstatohet se autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë 2 kamioncina nën 3.5 ton në pronësi ose me qera. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, me arsyetimin se: *“Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik “Udha” sh.p.k, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se: Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3.7 të Dokumentave Standarde të Tenderit-, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik që nevojiten në ekzekutimin e kontratës, Për mjetin me targë AA251HE, të deklaruar kamioncinë nën 3.5 ton, referuar dokumentacionit provues, në lejen e qarkullimit me nr.PED0112115 pika 23.Masa maksimale e autorizuar është 7490 kg. Gjithashtu, në çertifikatën e kontrollit teknik mjeti i përket kategorisë N2 (Kamion) dhe në çertifikatën e pronësisë së mjetit është E7-Kamion me vinç i montuar. Nga këto të dhëna rezulton se mjeti tejkalon tonazhin e kërkuar, duke mos përmbushur kriterin 2.3.7 për “Kamioncinë nën 3.5 ton” i cili sipas ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” neni 47, pika 2 (c) Kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3.5 ton ndërsa N2 (Kamion): mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë me të madhe se 3.5 ton dhe jo me të madhe se 12 ton, si dhe neni 54 pika 1(c)”. Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimi në SPE konstaton se operatori ekonomik “Udha” SHPK ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të firmosur dhe vulosur, ku në pjesën e III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ndër të tjera ka deklaruar: “Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të më vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar kontratën si më poshtë: .....Kamioncinë nën 3.5 ton, AB 810 NM, me nr. leje qarkullimi PED0724824, dhe nr. Shasie ZCF02973005835308, kamioncinë nën 3.5 ton AA 251 HE, me nr. leje qarkullimi PED0112115, dhe nr. shasie ĒDB67401315405274”. Referuar Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues e ka plotësuar atë në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.7 të shtojcës nr. 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumentave të tenderit. Referuar pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, konstatohet, se*

ligjvënësi ka parashikuar se “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”. Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik “Udha” SHPK është kualifikuar në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Udha” SHPK, me anë të shkresës nr. 551/4 prot., datë 06.03.2026, i kërkoj autoriteti kontraktor, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Udha” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Nëpërmjet shkresës me nr. 1794/1 prot., datë 10.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 551/5 prot., datë 12.03.2026 me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar nga autoriteti kontraktor dokumentacioni i dorëzuar fizikisht pranë këtij të fundit, nga operatori ekonomik “Udha” SHPK gjithsej 374 faqe.

III.1.13. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “Udha” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet se operatori ekonomik “Udha”, shpk ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të nënshkruar dhe vulosur, si dhe ndër të tjera ka dorëzuar edhe - *Leje qarkullimi Nr. PED0112115, për mjetin me targë AA 251 HE. - Certifikatë Pronësie e Mjetit Rrugor. - Certifikatë nr. 22 datë 05.08.2025 Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, për mjetin AA 251 HE Mercedes Benz. - Licencë nr. 03, datë 04.08.2025 Për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit. - Foto e mjetit. - Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore për mjetin me targë AA 251 HE. - Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, nr. 9043671, datë 02.10.2025.* Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Udha” SHPK, si dhe nga verifikimi i lejes së qarkullimit nr. PED0112115 për mjetin me targë AA 251 HE Komisioni konstaton, se në lejen e qarkullimit në pikën 23. Masa maksimale e autorizuar (kg) përcaktohet 7490, ndërsa në pikën 24. Masa e mjetit bosh (kg) përcaktohet 4680. Nga ky dokumentacion rezulton se, mjeti me targë AA 251 HE ka tonazh transportues 2.810 ton, duke përmbushur në këtë mënyrë kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.7 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Në këto kushte arsyeja e skualifikimit të KVO-së nuk qëndron.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Udha” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Udha” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “Për mjetin e deklaruar autobot uji me targë AA687DR, nga dokumentacioni i paraqitur, sipas lejes së qarkullimit, (J.1) Destinacioni dhe përdorimi i mjetit, rezulton automjet për transport mallrash të rrezikshëm, i cili nga natyra dhe destinacioni i përdorimit nuk përrputhet me mjetin e kërkuar dhe të deklaruar për këtë procedurë. Çdo ndryshim i kryer në destinacionin e përdorimit të mjetit duhet të reflektohet në lejen e qarkullimit. Për rrjedhojë, kërkesa e kriterit sipas pikës 2.3.7, nuk konsiderohet e plotësuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të modifikuar pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, është parashikuar si vijon:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë.

- Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera.

<b>I. MAKINERI</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Pronësia</b>
Automjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton.	Copë	3	Pronësi ose me qera
Kamionçinë nën 3.5 ton.	Copë	2	Pronësi ose me qera
Eskavator.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshës i tonazhit të madh.	Copë	2	Pronësi ose me qera
Grejder.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Autobot uji.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul asfalti.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Makineri për skarifikim asfalti.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Autovinç	Copë	1	Pronësi ose me qera
<b>II. PAJISJE</b>			
Betonierë.	copë	1	Pronësi ose me qera

Matrapik.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Vibrator (betoni).	copë	1	Pronësi ose me qera
Jelekë fosforeshentë/uniforma pune.	copë	40	Pronësi ose me qera
Kallëp dërrase (armaturë).	m <sup>2</sup>	140	Pronësi ose me qera
Karroca dore.	copë	1	Pronësi ose me qera
Tabela rrugore (për punime në rrugë).	copë	4	Pronësi ose me qera
Kokore për punonjësit.	copë	40	Pronësi ose me qera
Kuti e ndihmës së shpejtë.	copë	1	Pronësi ose me qera

- g) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- h) *Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).*
- i) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata perkatese noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- j) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- k) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 08.pika C (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- l) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*

**Shenim-** *Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 , ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar.*

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe shkresës me nr. 1794/1 prot., datë 10.03.2026, protokolluar pranë KPP-së me nr. 551/5 prot., datë 12.03.2026 rezulton se operatori ekonomik “*Udha*” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “*Udha*” SHPK të nënshkruar dhe vulosur, ku në pjesën III Kriteret e Përzgjedhjes kualifikimit, pika D Deklaratë “*Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate*”, ndër të tjera evidentohet se ka deklaruar Kamioncinë nën 3.5 ton mjetin me targë AA 687 DR, nr. Lejes së qarkullimit PED00092424, nr. Shasisë ËDB65209515946366.
- Leje qarkullimi Nr serial 0000000608852, për mjetin me targë AA 687 DR, me nr. Shasisë ËDB65209515946366.
- Certifikatë nr. 21 datë 05.08.2025 Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, për mjetin AA 687 DR Mercedes Benz.
- Licencë nr. 03, datë 04.08.2025 Për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit.
- Foto e mjetit.
- Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore për mjetin me targë AA 687 DR.
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, nr. 6365972, datë 09.02.2025.

III.2.3. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe*

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”.

III.2.8. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose
- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.2.9. Në nenin 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod, klasifikohen si vijon:

- a) mjete që lëvizin me forcën e krahut;
- b) mjete të tërhequra me kafshë;
- c) mjete me pedal;
- d) slita;
- e) ciklomotori;
- f) motomjete;
- g) automjete;
- h) trolejbusë;
- i) rimorkio;
- j) makina bujqësore;
- k) makina teknologjike;
- l) mjete rrugore të veçanta.

2. Mjete me motor dhe rimorkiot e tyre, sipas shkronjave “e”, “f”, “g”, “h”, “i” “j” dhe “l”, të pikës 1, të këtij neni, klasifikohen, gjithashtu, në bazë të kategorive ndërkombëtare si më poshtë:

a) - *Kategoria L1: mjete me dy rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h, fuqia maksimale nuk është më shumë se 4 kË në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L2: mjete me tri rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h; rendimenti maksimal neto i fuqisë nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L3: mjete me dy rrota, pa kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L4: mjete me dy rrota, me kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L5: mjete me tri rrota të përshtatura simetrikisht, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L6: mjete me katër rrota të lehta, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 350 kg, pa përfshirë masën e baterive në rastin e automjeteve elektrike, me shpejtësi maksimale të projektuar jo më të madhe se 45 km/h, cilindrata e motorit të mos i kalojë 50 cm<sup>3</sup> dhe rendimenti maksimal neto i të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme e të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L7: mjete me katër rrota të ndryshme nga L6, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 400 kg (550 kg për automjetet e synuara për transportimin e mallrave), pa përfshirë masën e baterive, në rastin e automjeteve elektrike, dhe fuqia maksimale neto e motorit e të cilave nuk është më shumë se 15 kË;*

b) - *kategoria M: mjete me motor të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria M1: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që nuk kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit;*

- *kategoria M2: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë deri 5 tonë;*

- *kategoria M3: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 tonë;*

c) - *kategoria N: mjete me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë;*

- *kategoria N2: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 12 tonë;*

- *kategoria N3: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë;*

d) - *kategoria O: rimorkiot (përfshirë edhe gjysmërimorkiot);*

- *kategoria O1: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0,75 tonë,*

- *kategoria O2: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0,75 tonë, por jo më të madhe se 3,5 tonë;*

- *kategoria O3: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë;*

- *kategoria O4: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë.*

dh) - *Kategoria T: traktorët me rrota;*

- *Kategoria T1: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me boshtin më të afërt te drejtuesi, që ka gjerësi minimale zinxhiri prej jo më pak se 1150 mm, me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 1 000 mm;*

- *Kategoria T2: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me gjerësi minimale zinxhiri prej jo më pak se 1150 mm, e një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 600 mm;*

- *Kategoria T3: traktorët e pajisur me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h dhe me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej jo më shumë se 600 kg;*

- *Kategoria T4: traktorët e pajisur me rrota për qëllime të veçanta, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria T5: traktorët e pajisur me rrota me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria C: traktorët me zinxhirë të pandërprerë;*

*Traktorët me zinxhirë të pandërprerë që shtyhen dhe drejtohen nga zinxhirë të pandërprerë dhe kategoritë e të cilëve, C1 deri C5, përcaktohen në analogji me kategoritë T1 deri T5.*

III.2.10. Në nenin 54 “Automjetet” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

*I. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Automjetet ndahen në:*

*a) Autovetura: mjete të destinuara për transport njerëzish, që kanë maksimumi nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;*

*b) Autobus: mjet i destinuar për transport njerëzish me më shumë se nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;*

*c) Automjet për transport të përzier: mjet që ka një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike a me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;*

*d) Kamion: mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave;*

*e) Tërheqës: mjet i destinuar vetëm për tërheqjen e rimorkiove ose gjysmërimorkiove;*

*f) Automjet për transport të veçantë: mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma specialë që i shërbejnë këtij qëllimi;*

*g) Automjet që përdorim të veçantë: mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.*

*h) Autotrenat: komplekse mjeteshe të përbëra nga dy njësi të veçanta të lidhura bashkë, nga të cilat njëra është udhëzuese; vetëm për zbatimin e nenit 61, pikat 1 dhe 2, autotrenat që kanë në*

mënyrë të përhershme pajisje të veçanta për transportin e mallrave të përcaktuar në aktet në zbatim, do të përbëjnë një njësi të vetme. Në çdo rast, nëse tejkalohej përmasat gabarite kufitare të përcaktuara në nenin 61, mjete ose transporti konsiderohet jashtë norme;

- i) Gjysmërimorkiatorë: mjete të përbëra nga një tërheqës dhe nga një gjysmërimorkio;
- j) Artikular: është autobus i përbërë nga dy pjesë të ngurta të lidhura ndërmjet tyre nëpërmjet një mekanizmi të artikullar; në këta tipa mjetesh pasagjerët e secilës pjesë qarkullojnë lirisht nga njëra te tjetra; ndarja ose lidhja e të dy pjesëve të mjetit me njëra-tjetrën bëhet vetëm në oficinë;
- k) Autokampe: mjete që kanë një karroceri speciale dhe janë të pajisur në mënyrë të përhershme për t'u përshtatur transportit dhe strehimit të deri shtatë njerëzve, duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit;
- l) Makina ngarkim-transporti: mjete ose komplekse mjetesh që kanë pajisje të veçanta për ngarkimin dhe transportin e materialeve që përdoren, ose janë produkt i punimeve të ndërtimit dhe të gërmimeve në miniera, si dhe të materialeve që plotësojnë gjatë ecjes ciklin e prodhimit të tyre; këto mjete ose komplekse mjetesh mund të përdoren në transporte që kalojnë kufirin e ngarkesës të përcaktuar në nenin 62, por jo atë të nenit 10, pika 8; në çdo rast nuk duhet të kalojnë përmasat gabarite kufitare të përcaktuara në nenin 61; makinat e ngarkim-transportit duhet, gjithashtu, të jenë të përshtatshme për t'u përdorur në kantiere ose për përdorim të përzier në rrugë dhe jashtë saj.

2. Në aktet në zbatim përcaktohen, sipas pajisjeve të tyre shoqëruese, tipat e automjeteve që regjistrohen si automjete për transporte të veçanta dhe si automjete për përdorime të veçanta.

III.2.11. Në nenin 56 "Automjetet" të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar parashikohet se:

1. Rimorkiot janë mjete të destinuara për t'u tërhequr nga automjetet, për të cilat flitet në nenin 54, dhe nga trolejbuset për të cilët flitet në nenin 55, duke përfshirë artikulet.

2. Rimorkiot ndahen në:

- a) rimorkio ose gjysmërimorkio për transport pasagjerësh, ku përfshihen rimorkiot me të paktën dy akse;
- b) rimorkio për transport mallrash;
- c) rimorkio për transport të veçantë, sipas kuptimit përkatës që është dhënë në shkronjën "f" të nenit 54;
- d) rimorkio për përdorim të veçantë, sipas kuptimit të dhënë në shkronjat "g" dhe "h" të nenit 54;
- e) rimorkio kamp: rimorkio me një aks ose me dy akse të vendosura në një largësi jo më shumë se një metër, që kanë një karroceri të veçantë dhe të pajisur për t'u përdorur si vendstrehim, por vetëm kur mjete është i ndalur;
- f) rimorkio për transportin e pajisjeve turistike dhe sportive: rimorkio me një aks ose me dy akse të vendosura në një largësi jo më shumë se një metër, të cilat kanë pajimin e nevojshëm për transportimin e pajisjeve turistike dhe sportive, si barka, planera etj.

3. Gjysmërimorkiot janë mjete të ndërtuara në mënyrë të tillë që një pjesë e tyre t'i mbivihet njësisë motorike dhe që një pjesë e konsiderueshme e ngarkesës së saj të mbahet ngakjo njësi.

4. Karrelat janë mjete shtojcë që nuk kanë më shumë se dy rrota dhe janë të destinuara për transport bagazhi, pajisjesh etj. si këto; tërhiqen nga automjetet, për të cilat flitet në nenin 54,

pika 1, duke përjashtuar ato për të cilat flitet te shkronjat “h”, “i” dhe “l”. Karrelat konsiderohen pjesë përbërëse e automjeteve, kur hyjnë brenda përmasave gabarite kufitare dhe të ngarkesës së lejuar të përcaktuar nga nenet 61 dhe 62.

III.2.12. Në nenin 198 “Motomjetet për transporte të veçanta dhe motomjete për përdorim të veçantë (Neni 53 i Kodit Rrugor)” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Në bazë të nenit 53, pika 1 e Kodit Rrugor, janë klasifikuar për transporte të veçanta, motomjetet e pajisura përgjithmonë me një rën nga karrocëritë, si vijon:

- a) dhomë izometrike ose e zbuluar, me ose pa grup frigoriferik, e vlerësuar si e përshtatshme për transportin e ushqimeve në një regjim me temperaturë të kontrolluar;
- b) kazan i kthyesëm, i mbyllur, me hapje vetëm nga sipër ose nga prapa, për transportin e mbeturinave të forta;
- c) cisterna për transportin e lëngjeve apo të ujërave të zeza;
- ç) cisterna apo kontenierë të pajisur posaçërisht për transportin e materialeve të shkrira apo në formë pluhuri;
- d) karrocëri të tjera, të vlerësuara të përshtatshme për transport të veçantë nga Ministria e Transportit.

2. Klasifikohen për përdorim të veçantë, sipas nenit 53, pika 1 e Kodit Rrugor, motomjetet si vijon:

- a) të pajisura me shkallë;
- b) të pajisura me pompë;
- c) të pajisura me vinç gru;
- ç) të pajisura me pedane apo me kosh të ngritshëm;
- c) të pajisura për ekspozime reklamash;
- dh) të pajisura me pastrues;
- d) të pajisura me ujitës;
- ë) të pajisura me ambulancë apo me laborator të lëvizshëm;
- e) të pajisura me saldatrice;
- f) të pajisura me gërmuese;
- gj) të pajisura me shpues;
- g) të pajisura me sharrë;
- h) të pajisura me gjenerator;
- i) të pajisura me vegla të tjera, të vlerësuara, nga Ministria e Transportit të përshtatshme për përdorime të veçanta.

3. Motomjeteve të përdorimeve të veçanta, në lejen e qarkullimit u shënohet një kapacitet fiktiv, për qëllime fiskale (taksash), që përcaktohet nga diferenca ndërmjet peshës së përgjithshme të mjetit dhe tarës së këtij mjeti, të pajisur me karrocëri normale ose, kur nuk ekziston ky version, me tarën (pesha bosh) e motomjetit (pa karrocëri) të rritur me 20 për qind.

III.2.13. Në nenin 201 “Automjetet për transport dhe për përdorim të veçantë (Neni 54 i Kodit Rrugor)” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e

*Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:*

*1. Sipas nenit 54, pika 2 e Kodit Rrugor, klasifikohen automjete për transporte të veçanta ato automjete, të pajisura me njërën nga karrocëritë e poshtëshënuara:*

*a) dhomë izotermike apo e izoluar, me apo pa grup frigoriferik, e njohur si e përshtatshme për transportin e ushqimeve në regjim frigoriferik, në temperaturë të kontrolluar;*

*b) karrocëri të përshtatshme për ngarkimin, përpunimin, transportin dhe shkarkimin e mbeturinave të forta të qyteteve;*

*c) cisternat për transportin e lëngjeve apo të ujërave të zeza;*

*ç) cisterna apo kontenierë, të pajisur posaçërisht për transportin e materialeve të shkrira dhe në formë pluhuri;*

*d) shasi, të pajisura me sisteme kapëse për transportin e kontenierëve apo të shtëpive të lëvizshme, të tipit të unifikuar;*

*dh) shasi me krahë për transportin e trupave të lidhur;*

*e) betoniere;*

*ë) karrocëri për transportin e personave në kushte të veçanta dhe që dallohen me anë të një pajisjeje të veçantë, të përshtatshme për këtë qëllim;*

*f) karrocëri të pajisura në mënyrë të veçantë për transportin e materialeve të klasifikuara të rrezikshme nga ADR-ja apo në bazë të normativave përkatëse të Komunitetit Europian;*

*g) karrocëri të veçanta, me udhëzues rrotash dhe plan të pjerrët ngarkimi, të caktuara vetëm për transport automjetesh;*

*gj) karrocëri të tjera, të njohura nga Ministria e Transportit si të përshtatshme për transporte të veçanta.*

*2. Klasifikohen, në bazë të nenit 54, pika 2 e Kodit Rrugor, për përdorim të veçantë, automjetet e mëposhtme:*

*a) traktori rrugor;*

*b) autopastruesja;*

*c) autopompa;*

*ç) autopastruesja e borës;*

*d) autoujitësja;*

*dh) autooficina;*

*e) automjetet e shkallës dhe automjetet për riparimin e linjave elektrike;*

*ë) automjetet me vinq gru;*

*f) automjetet për ndihmën e shpejtë në rrugë;*

*g) automjetet me pedane apo kosh të ngritshëm;*

*gj) autobluajtësja shkoqëse;*

*h) autofshirësja;*

*i) autoambulanca;*

*j) automjetet e varrimit;*

*k) autofurgonët e blinduar, për transportin e të burgosurve;*

*l) automjetet për dezinfektim;*

m) autoreklammat dhe mjetet për ekspozime reklamash, të pajisura me karroceri të veçantë për këtë funksion, që nuk lejon përdorime të tjera dhe ku sendet që transportohen nuk hiqen kurrë nga mjeti;

n) automjetet për radio, televizion, kinema;

o) automjetet e caktuara për shfaqje në lëvizje;

p) automjetet e pajisura me ambulanca të lëvizshme;

q) autotendat;

r) automjetet e pajisura për spërkatje të fushave;

rr) autosaldatriçja;

s) automjet me aparatura telegrafike;

sh) autogërmuesja;

t) autoshpuesja;

th) autosharra;

u) automjetet e pajisura me gjenerator;

v) autopompa për beton;

z) automjetet e tjera të pajisura me vegla të njohura nga Ministria e Transportit, të përshtatshme për përdorim të veçantë.

3. Për automjetet e transporteve dhe të përdorimeve të veçanta, në lejen e qarkullimit u shënohet një kapacitet fiktiv për qëllime fiskale (taksash), i cili përcaktohet nga diferenca ndërmjet peshës së përgjithshme të mjetit dhe tarës së këtij mjeti të pajisur me karroceri normale ose, kur nuk ekziston ky version, me tarën e automjetit (pa karroceri) të rritur me 20 për qind.

III.2.14. Në nenin 202 “Rimorkiot për transport dhe përdorim të veçantë (Neni 56 i Kodit Rrugor)” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Klasifikohen, në bazë të nenit 56, pika 2, shkronja “c” e Kodit Rrugor, për transport të veçantë, rimorkiot dhe gjysmërimorkiot e pajisura me njërën nga karrocëritë e mëposhtme, të vendosura në mënyrë të përhershme:

a) dhomë izotermike apo e izoluar, me ose jo grup frigoriferik, që është e përshtatshme për transportimin e ushqimeve në një regjim temperature të kontrolluar;

b) karrocëri të përshtatshme për ngarkimin, përpunimin, transportimin dhe shkarkimin e plehrave të forta të qyteteve;

c) cisternat për transportimin e lëngjeve dhe të ujërave të zeza;

ç) cisterna apo kontenierë, të pajisur posaçërisht për transportin e materialeve të shkrira apo në formë pluhuri;

d) shasi, të pajisura me sisteme kapjeje për transportin e kontenierëve apo të shtëpive të lëvizshme, të tipit të unifikuar;

dh) shasi me krahë për transportin e trupave të lidhur;

e) betoniere;

ë) karrocëri të caktuara për transportin e personave në kushte të veçanta dhe të dallueshme nga një pajisje e përshtatshme për këtë qëllim;

f) karroceri, të pajisura posaçërisht për transportin e materialeve të klasifikuara të rrezikshme në bazë të ADR-së apo të normativave përkatëse të Komunitetit Europian;

g) karroceri e veçantë, me udhëzues rrotash dhe plan të pjerrët ngarkimi, e përshtatshme për transportin e makinave;

gj) karroceri të tjera, të njohura nga Ministria e Transportit si të përshtatshme për transport të veçantë.

2. Klasifikohen, në bazë të nenit 56, pika 2, shkronja “d” e Kodit Rrugor, për përdorim të veçantë, këto rimorkio:

a) të caktuara vetëm për t’u shërbyer automjeteve për përdorim të veçantë;

b) të karrocuara në përputhje me automjetin për përdorim të veçantë, të cilit i është caktuar;

c) të përshtatura për transportin në rrugë të mjeteve hekurudhore.

3. Për rimorkiot e përdorimeve të veçanta, në lejen e qarkullimit shënohet një kapacitet fiktiv për qëllime fiskale (taksash), që përcaktohet nga diferenca ndërmjet peshës së përgjithshme të mjetit dhe tarës së këtij mjeti të pajisur me karroceri normale ose, kur nuk ekziston ky version, me tarën e rimorkios (pa karroceri), të rritur me 20 për qind.

III.2.15. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.16. Konkretisht, referuar kriterit në pikën 2.3.7 për disponimin e mjeteve që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, konstatohet se autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë 1 autobot uji në pronësi ose me qera. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, me arsyetimin se: “Për mjetin e deklaruar autobot uji me targë AA687DR, nga dokumentacioni i paraqitur, sipas lejes së qarkullimit, (J.1) Destinacioni dhe përdorimi i mjetit, rezulton automjet për transport mallrash të rrezikshëm, i cili nga natyra dhe destinacioni i përdorimit nuk

përputhet me mjetin e kërkuar dhe të deklaruar për këtë procedurë. Çdo ndryshim i kryer në destinacionin e përdorimit të mjetit duhet të reflektohet në lejen e qarkullimit. Për rrjedhojë, kërkesa e kriterit sipas pikës 2.3.7, nuk konsiderohet e plotësuar”. Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimi në SPE konstaton se operatori ekonomik “Udha” SHPK ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të firmosur dhe vulosur, ku në pjesën e III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ndër të tjera ka deklaruar: “Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të më vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar kontratën si më poshtë: .....Autobot Uji me targë AA 687 DR, me nr. leje qarkullimi PED00092424, dhe nr. Shasie ĒDB65209515946366”. Referuar Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues e ka plotësuar atë në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.7 të shtojcës nr. 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumentave të tenderit. Referuar pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, konstatohet, se ligjvënësi ka parashikuar se “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”. Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik “Udha” SHPK është kualifikuar në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Udha” SHPK, me anë të shkresës nr. 551/4 prot., datë 06.03.2026, i kërkoi autoriteti kontraktor, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Udha” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Nëpërmjet shkresës me nr. 1794/1 prot., datë 10.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 551/5 prot., datë 12.03.2026 me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar nga autoriteti kontraktor dokumentacioni i dorëzuar fizikisht pranë këtij të fundit, nga operatori ekonomik “Udha” SHPK gjithsej 374 faqe.

III.1.13. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “Udha” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet se operatori ekonomik “Udha”, shpk ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të nënshkruar dhe vulosur, si dhe ndër të tjera ka dorëzuar edhe - Leje

qarkullimi Nr serial 000000608852, për mjetin me targë AA 687 DR, me nr. Shasisë ËDB65209515946366. - Certifikatë nr. 21 datë 05.08.2025 Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, për mjetin AA 687 DR Mercedes Benz. - Licencë nr. 03, datë 04.08.2025 Për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit. - Foto e mjetit. - Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore për mjetin me targë AA 687 DR. -Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, nr. 6365972, datë 09.02.2025. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes "Udha" SHPK, KPP gjykon, se nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik "Udha" SHPK rezulton, se në lejen e qarkullimit të mjetit lëshuar nga institucioni përkatës rezulton se ky mjetë shërben edhe për transport mallrash të rrezikshëm, ndërkohë që në nenin 201 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 "Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, klasifikohen automjete për transporte të veçanta ato automjete, të pajisura me njërin nga karrocetë e poshtëshënuara: c) cisternat për transportin e lëngjeve apo të ujërave të zeza; f) karrocetë të pajisura në mënyrë të veçantë për transportin e materialeve të klasifikuara të rrezikshme nga ADR-ja apo në bazë të normativave përkatëse të Komunitetit Europian; ndërsa në pikën 2 të këtij neni përcaktohet se 2. Klasifikohen, në bazë të nenit 54, pika 2 e Kodit Rrugor, për përdorim të veçantë, automjetet e mëposhtme: d) autoujitësja; mjeti i sipërcituar jo vetëm që e përmbush kriterin e sipërcituar por edhe e tejkalon atë. Së pari, duhet theksuar se klasifikimi i një mjeti në lejen e qarkullimit si mjet për transport mallrash të rrezikshëm nuk përjashton në mënyrë automatike përdorimin e tij për transport uji, pasi kjo kategori shpesh lidhet me karakteristikat teknike të depozitës (cisternës) dhe standardet e sigurisë që ajo përmbush, dhe jo domosdoshmërisht me përdorimin konkret që i bëhet në çdo rast; për rrjedhojë, një autobot i tillë mund të përdoret ligjërisht për transport uji, veçanërisht kur nuk ka asnjë ndalim specifik në dokumentacionin teknik apo në legjislacionin përkatës që e kufizon këtë përdorim. Së dyti, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik në fuqi, autoriteti kontraktor ka detyrimin të kryejë një vlerësim objektiv dhe substancial të ofertës, duke u fokusuar në përmbushjen reale të kërkesave teknike dhe funksionale të përcaktuara në dokumentet e tenderit, dhe jo në interpretime formale apo të ngushta të dokumentacionit që nuk ndikojnë në aftësinë e operatorit për të realizuar kontratën; në këtë kuadër, nëse mjeti në fjalë përmbush, funksionin e transportit të ujit dhe standardet teknike të kërkuara, atëherë çdo skualifikim mbi bazë të etiketimit formal në lejen e qarkullimit bie ndesh me parimin e proporcionalitetit. Së treti, parimi i mosdiskriminimit dhe i barazisë në trajtim përsa kohë në këto dokumentat stadarte të tenderit nuk është specifikuar në mënyrë eksplicite që mjeti duhet të jetë i klasifikuar në lejen e qarkullimit ekskluzivisht si "autobot uji" dhe jo si mjet me kapacitete të tjera teknike, atëherë përdorimi i këtij kriteri si bazë skualifikimi përbën ndryshim të rregullave të garës pas hapjes së ofertave, çka është e ndaluar. Së katërti, në praktikën administrative dhe në interpretimin e normave teknike të mjeteve rrugore, rëndësi parësore ka funksionaliteti dhe përdorimi real i mjetit, i cili mund të provohet përmes dokumenteve shtesë si certifikata teknike, fotografi, kontrata përdorimi apo deklarata të prodhuesit, dhe jo vetëm përmes një përshkrimi të përgjithshëm në lejen e qarkullimit; për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të kërkonte sqarime shtesë në vend që të merrte një vendim të menjëhershëm skualifikimi, në përputhje me parimin e administrimit të drejtë dhe të plotë të procedurës. Në përfundim, skualifikimi në fjalë është i pambështetur ligjërisht, joproporcional dhe në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit

publik, pasi nuk bazohet në një mungesë reale të kapacitetit teknik të operatorit ekonomik, por në një interpretim formal dhe të ngushtë të dokumentacionit, duke cenuar kështu konkurrencën dhe duke diskriminuar padrejtësisht ofertuesin. KPP gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur operatori ekonomik dëshmon se disponon mjetin e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor.

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi”. Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e punëve të kërkuara është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Udha” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Udha” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3-6(a) të Dokumentave Standarde të Tenderit-Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 8 (tetë) punonjës manovratorë të mjeteve/makinerive të rënda specifikisht sipas profileve të mëposhtme: • Manovrator asfaltoshtruese → 1 manovrator • Manovrator eskavatori → 1 manovrator • Manovrator grejderi → 1 manovrator • Manovrator rruli vibrues → 2 manovrator, • Manovrator rruli asfalti → 1 manovrator, • Manovrator makinerie skarifikimi asfalti → 1 manovrator, • Manovrator Autovinçi → 1 manovrator Për çdo profil punonjësi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhës së realizimit të kontratës), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet perkatëse sipas modaliteteve të urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019. Sipas urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019, neni 8 dhe kërkesa e DST-së pika 2.3-6 (a), kërkohej specifikisht manovratorët si më poshtë: • 1 (një) manovrator me dëshmi të aftësisë profesionale për Eskavatorist (Manovrator eskavatori)

• 6(gjashtë)manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist(1 Manovrator asfaltoshtruese; 1 Manovrator grejderi; 2 Manovrator rruli vibrues;1 Manovrator rruli asfalti; 1 Manovrator makinerie skarifikimi asfalti) • 1(një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për Automakinist(Manovrator Autovinçi) Operatori ekonomik “Udha” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin provues për punonjës manovratorë të mjeteve/makinerive të rënda sipas dëshmive të aftësisë profesionale si më poshtë: • 1(një) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Eskavatorist • 3(tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist • 4(katër) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Automakinist Për rrjedhojë, mungojnë 3(tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist, nga 6(gjashtë) të kërkuar dhe kërkesa e kriterit 2.3-6(a) nuk konsiderohet e plotësuar. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur është në kundërshtim me pikën 2.3.7 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës dhe 2.3.6 (a) Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik dhe përbën kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik “Udha” sh.p.k. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion e vlefshëm sipas kërkesave të nenit 82.5 te Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të modifikuar pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik” të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, është parashikuar si vijon:

### **2.3-6-Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik**

a)Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **8 (tete) punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerive të rënda specifikisht sipas profileve te mëposhtme:

- Manovrator asfaltoshtruese→**1 manovrator**
- Manovrator eskavatori→**1 manovrator**
- Manovrator grejderi→**1 manovrator**
- Manovrator rruli vibrues →**2 manovrator,**
- Manovrator rruli asfalti →**1 manovrator,**
- Manovrator makinerie skarifikimi asfalti→**1 manovrator,**
- Manovrator Autovinçi→**1 manovrator**

Për cdo profil punonjesi teknik si me siper duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates), dëshmite e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet perkatese sipas modaliteteve te **urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019**

**Shenim-** Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar.

III.3.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe shkresës me nr. 1794/1 prot., datë 10.03.2026, protokolluar pranë KPP-së me nr. 551/5 prot., datë 12.03.2026 rezulton se operatori ekonomik “*Udha*” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “*Udha*” SHPK të nënshkruar dhe vulosur;  
Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinist në emër të z. E. P;  
Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinist në emër të z. N. B;  
Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinistë në emër të z. G. Ç;  
Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinistë në emër të z. SH. Ç;  
Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për eskavatorist në emër të z. F. H;  
Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për eskavatorist në emër të z. E. S;  
Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për buldozerist në emër të z. F. H;  
Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për buldozerist në emër të z. L. XH;  
Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për buldozerist në emër të z. V. K;

III.3.3. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.4. Në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.3.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.3.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”.

III.3.8. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.3.9. Në nenin 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod, klasifikohen si vijon:

a) mjete që lëvizin me forcën e krahut;

b) mjete të tërhequra me kafshë;

c) mjete me pedal;

d) slita;

e) ciklomotori;

f) motomjete;

g) automjete;

h) trolejbusë;

i) rimorkio;

j) makina bujqësore;

k) makina teknologjike;

l) mjete rrugore të veçanta.

2. Mjete me motor dhe rimorkiot e tyre, sipas shkronjave “e”, “f”, “g”, “h”, “i” “j” dhe “l”, të pikës 1, të këtij neni, klasifikohen, gjithashtu, në bazë të kategorive ndërkombëtare si më poshtë:

a) - *Kategoria L1: mjete me dy rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h, fuqia maksimale nuk është më shumë se 4 kË në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L2: mjete me tri rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h; rendimenti maksimal neto i fuqisë nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L3: mjete me dy rrota, pa kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L4: mjete me dy rrota, me kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L5: mjete me tri rrota të përshtatura simetrikisht, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L6: mjete me katër rrota të lehta, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 350 kg, pa përfshirë masën e baterive në rastin e automjeteve elektrike, me shpejtësi maksimale të projektuar jo më të madhe se 45 km/h, cilindrata e motorit të mos i kalojë 50 cm<sup>3</sup> dhe rendimenti maksimal neto i të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme e të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L7: mjete me katër rrota të ndryshme nga L6, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 400 kg (550 kg për automjetet e synuara për transportimin e mallrave), pa përfshirë masën e baterive, në rastin e automjeteve elektrike, dhe fuqia maksimale neto e motorit e të cilave nuk është më shumë se 15 kË;*

b) - *kategoria M: mjete me motor të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria M1: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që nuk kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit;*

- *kategoria M2: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë deri 5 tonë;*

- *kategoria M3: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 tonë;*

c) - *kategoria N: mjete me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë;*

- *kategoria N2: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 12 tonë;*

- *kategoria N3: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë;*

d) - *kategoria O: rimorkiot (përfshirë edhe gjysmërimorkiot);*

- *kategoria O1: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0,75 tonë,*

- *kategoria O2: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0,75 tonë, por jo më të madhe se 3,5 tonë;*

- *kategoria O3: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë;*

- *kategoria O4: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë.*

dh) - *Kategoria T: traktorët me rrota;*

- *Kategoria T1: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me boshtin më të afërt te drejtuesi, që ka gjerësi minimale zinxhiri prej jo më pak se 1150 mm, me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 1 000 mm;*

- *Kategoria T2: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me gjerësi minimale zinxhiri prej më pak se 1150 mm, e një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 600 mm;*

- *Kategoria T3: traktorët e pajisur me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h dhe me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej jo më shumë se 600 kg;*

- *Kategoria T4: traktorët e pajisur me rrota për qëllime të veçanta, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria T5: traktorët e pajisur me rrota me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria C: traktorët me zinxhirë të pandërprerë;*

*Traktorët me zinxhirë të pandërprerë që shtyhen dhe drejtohen nga zinxhirë të pandërprerë dhe kategoritë e të cilëve, C1 deri C5, përcaktohen në analogji me kategoritë T1 deri T5.*

III.3.10. Në nenin 54 “Automjetet” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

*1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Automjetet ndahen në:*

*a) Autovetura: mjete të destinuara për transport njerëzish, që kanë maksimumi nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;*

*b) Autobus: mjet i destinuar për transport njerëzish me më shumë se nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;*

*c) Automjet për transport të përzier: mjet që ka një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike a me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;*

*d) Kamion: mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave;*

*e) Tërheqës: mjet i destinuar vetëm për tërheqjen e rimorkiove ose gjysmërimorkiove;*

*f) Automjet për transport të veçantë: mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma specialë që i shërbejnë këtij qëllimi;*

*g) Automjet që përdorim të veçantë: mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.*

*h) Autotrenat: komplekse mjetesh të përbëra nga dy njësi të veçanta të lidhura bashkë, nga të cilat njëra është udhëzuese; vetëm për zbatimin e nenit 61, pikat 1 dhe 2, autotrenat që kanë në*

mënyrë të përhershme pajisje të veçanta për transportin e mallrave të përcaktuar në aktet në zbatim, do të përbëjnë një njësi të vetme. Në çdo rast, nëse tejkalohehen përmasat gabarite kufitare të përcaktuara në nenin 61, mjete ose transporti konsiderohet jashtë norme;

- i) Gjysmërimorkiatorë: mjete të përbëra nga një tërheqës dhe nga një gjysmërimorkio;
- j) Artikular: është autobus i përbërë nga dy pjesë të ngurta të lidhura ndërmjet tyre nëpërmjet një mekanizmi të artikulluar; në këta tipa mjetesh pasagjerët e secilës pjesë qarkullojnë lirisht nga njëra te tjetra; ndarja ose lidhja e të dy pjesëve të mjetit me njëra-tjetrën bëhet vetëm në oficinë;
- k) Autokampe: mjete që kanë një karroceri speciale dhe janë të pajisur në mënyrë të përhershme për t'u përshtatur transportit dhe strehimit të deri shtatë njerëzve, duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit;
- l) Makina ngarkim-transporti: mjete ose komplekse mjetesh që kanë pajisje të veçanta për ngarkimin dhe transportin e materialeve që përdoren, ose janë produkt i punimeve të ndërtimit dhe të gërmimeve në miniera, si dhe të materialeve që plotësojnë gjatë ecjes ciklin e prodhimit të tyre; këto mjete ose komplekse mjetesh mund të përdoren në transporte që kalojnë kufirin e ngarkesës të përcaktuar në nenin 62, por jo atë të nenit 10, pika 8; në çdo rast nuk duhet të kalojnë përmasat gabarite kufitare të përcaktuara në nenin 61; makinat e ngarkim-transportit duhet, gjithashtu, të jenë të përshtatshme për t'u përdorur në kantiere ose për përdorim të përzier në rrugë dhe jashtë saj.

2. Në aktet në zbatim përcaktohen, sipas pajisjeve të tyre shoqëruese, tipat e automjeteve që regjistrohen si automjete për transporte të veçanta dhe si automjete për përdorime të veçanta.

III.3.11. Në nenin 56 “Rimorkiot” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Rimorkiot janë mjete të destinuara për t'u tërhequr nga automjetet, për të cilat flitet në nenin 54, dhe nga trolejbuset për të cilët flitet në nenin 55, duke përfshirë artikulet.

2. Rimorkiot ndahen në:

- a) rimorkio ose gjysmërimorkio për transport pasagjerësh, ku përfshihen rimorkiot me të paktën dy akse;
- b) rimorkio për transport mallrash;
- c) rimorkio për transport të veçantë, sipas kuptimit përkatës që është dhënë në shkronjën “f” të nenit 54;
- d) rimorkio për përdorim të veçantë, sipas kuptimit të dhënë në shkronjat “g” dhe “h” të nenit 54;
- e) rimorkio kamp: rimorkio me një aks ose me dy akse të vendosura në një largësi jo më shumë se një metër, që kanë një karroceri të veçantë dhe të pajisur për t'u përdorur si vendstrehim, por vetëm kur mjete është i ndalur;
- f) rimorkio për transportin e pajisjeve turistike dhe sportive: rimorkio me një aks ose me dy akse të vendosura në një largësi jo më shumë se një metër, të cilat kanë pajimin e nevojshëm për transportimin e pajisjeve turistike dhe sportive, si barka, planera etj.

3. Gjysmërimorkiot janë mjete të ndërtuara në mënyrë të tillë që një pjesë e tyre t'i mbivihet njësisë motorike dhe që një pjesë e konsiderueshme e ngarkesës së saj të mbahet ngakjo njësi.

4. Karrelat janë mjete shtojcë që nuk kanë më shumë se dy rrota dhe janë të destinuara për transport bagazhi, pajisjesh etj. si këto; tërhiqen nga automjetet, për të cilat flitet në nenin 54,

*pika 1, duke përjashtuar ato për të cilat flitet te shkronjat “h”, “i” dhe “l”. Karrelat konsiderohen pjesë përbërëse e automjeteve, kur hyjnë brenda përmasave gabaritë kufitare dhe të ngarkesës së lejuar të përcaktuar nga nenet 61 dhe 62.*

III.3.12. Në nenin 58 “Makinat teknologjike” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

*1. Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nganjë vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim.*

*2. Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, makinat teknologjike ndahen në:*

*a) makina që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut;*

*b) makina që zhbllokojnë rrugën nga bora ose ndihmëse që shpërndajnë rërë a gjëra të këtij lloji;*

*c) motopirunët dhe elektropirunët: mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve.*

*3. Makinat teknologjike vetëlëvizëse, sipas karakteristikave që kanë, mund të kenë jo më shumë se tri ndenjëse për personelin e shërbimit, duke përfshirë edhe drejtuesin e tyre.*

*4. Për t’iu përshtatur qarkullimit rrugor, këto makina nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 40 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale, kurse makinat teknologjike vetëlëvizëse me rrota jopneumatike a me zinxhirë nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 15 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale.*

III.3.13. Në nenin 198 “Motomjetet për transporte të veçanta dhe motomjete për përdorim të veçantë (Neni 53 i Kodit Rrugor)” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

*1. Në bazë të nenit 53, pika 1 e Kodit Rrugor, janë klasifikuar për transporte të veçanta, motomjetet e pajisura përgjithmonë me një rën nga karrocëritë, si vijon:*

*a) dhomë izometrike ose e zbuluar, me ose pa grup frigoriferik, e vlerësuar si e përshtatshme për transportin e ushqimeve në një regjim me temperaturë të kontrolluar;*

*b) kazan i kthyesëm, i mbyllur, me hapje vetëm nga sipër ose nga prapa, për transportin e mbeturinave të forta;*

*c) cisterna për transportin e lëngjeve apo të ujërave të zeza;*

*ç) cisterna apo kontenierë të pajisur posaçërisht për transportin e materialeve të shkrira apo në formë pluhuri;*

*d) karrocëri të tjera, të vlerësuara të përshtatshme për transport të veçantë nga Ministria e Transportit.*

*2. Klasifikohen për përdorim të veçantë, sipas nenit 53, pika 1 e Kodit Rrugor, motomjetet si vijon:*

*a) të pajisura me shkallë;*

*b) të pajisura me pompë;*

*c) të pajisura me vinç gru;*

- c) të pajisura me pedane apo me kosh të ngritshëm;
- c) të pajisura për ekspozime reklamash;
- dh) të pajisura me pastrues;
- d) të pajisura me ujitës;
- ë) të pajisura me ambulancë apo me laborator të lëvizshëm;
- e) të pajisura me saldatrice;
- f) të pajisura me gërmuese;
- gj) të pajisura me shpues;
- g) të pajisura me sharrë;
- h) të pajisura me gjenerator;
- i) të pajisura me vegla të tjera, të vlerësuara, nga Ministria e Transportit të përshtatshme për përdorime të veçanta.

3. Motomjeteve të përdorimeve të veçanta, në lejen e qarkullimit u shënohet një kapacitet fiktiv, për qëllime fiskale (taksash), që përcaktohet nga diferenca ndërmjet peshës së përgjithshme të mjetit dhe tarës së këtij mjeti, të pajisur me karroceri normale ose, kur nuk ekziston ky version, me tarën (pesha bosh) e motomjetit (pa karroceri) të rritur me 20 për qind.

III.3.14. Në nenin 201 “Automjetet për transport dhe për përdorim të veçantë (Neni 54 i Kodit Rrugor)” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Sipas nenit 54, pika 2 e Kodit Rrugor, klasifikohen automjete për transporte të veçanta ato automjete, të pajisura me njërën nga karrocëritë e poshtëshënuara:

- a) dhomë izotermike apo e izoluar, me apo pa grup frigoriferik, e njohur si e përshtatshme për transportin e ushqimeve në regjim frigoriferik, në temperaturë të kontrolluar;
- b) karrocëri të përshtatshme për ngarkimin, përpunimin, transportin dhe shkarkimin e mbeturinave të forta të qyteteve;
- c) cisternat për transportin e lëngjeve apo të ujërave të zeza;
- ç) cisterna apo kontenierë, të pajisur posaçërisht për transportin e materialeve të shkrira dhe në formë pluhuri;
- d) shasi, të pajisura me sisteme kapëse për transportin e kontenierëve apo të shtëpive të lëvizshme, të tipit të unifikuar;
- dh) shasi me krahë për transportin e trupave të lidhur;
- e) betoniere;
- ë) karrocëri për transportin e personave në kushte të veçanta dhe që dallohen me anë të një pajisjeje të veçantë, të përshtatshme për këtë qëllim;
- f) karrocëri të pajisura në mënyrë të veçantë për transportin e materialeve të klasifikuara të rrezikshme nga ADR-ja apo në bazë të normativave përkatëse të Komunitetit Europian;
- g) karrocëri të veçanta, me udhëzues rrotash dhe plan të pjerrët ngarkimi, të caktuara vetëm për transport automjetesh;
- gj) karrocëri të tjera, të njohura nga Ministria e Transportit si të përshtatshme për transporte të veçanta.

2. Klasifikohen, në bazë të nenit 54, pika 2 e Kodit Rrugor, për përdorim të veçantë, automjetet e mëposhtme:

- a) traktori rrugor;
- b) autopastruesja;
- c) autopompa;
- ç) autopastruesja e borës;
- d) autoujitësja;
- dh) autoofiçina;
- e) automjetet e shkallës dhe automjetet për riparimin e linjave elektrike;
- ë) automjetet me vinç gru;
- f) automjetet për ndihmën e shpejtë në rrugë;
- g) automjetet me pedane apo kosh të ngritshëm;
- gj) autobluajtësja shkoqëse;
- h) autofshirësja;
- i) autoambulanca;
- j) automjetet e varrimit;
- k) autofurgonët e blinduar, për transportin e të burgosurve;
- l) automjetet për dezinfektim;
- m) autoreklamata dhe mjetet për ekspozime reklamash, të pajisura me karroceri të veçantë për këtë funksion, që nuk lejon përdorime të tjera dhe ku sendet që transportohen nuk hiqen kurrë nga mjeti;
- n) automjetet për radio, televizion, kinema;
- o) automjetet e caktuara për shfaqje në lëvizje;
- p) automjetet e pajisura me ambulanca të lëvizshme;
- q) autotendat;
- r) automjetet e pajisura për spërkatje të fushave;
- rr) autosaldatriçja;
- s) automjet me aparatura telegrafike;
- sh) autogërmuesja;
- t) autoshpuesja;
- th) autosharra;
- u) automjetet e pajisura me gjenerator;
- v) autopompa për beton;
- z) automjetet e tjera të pajisura me vegla të njohura nga Ministria e Transportit, të përshtatshme për përdorim të veçantë.

3. Për automjetet e transporteve dhe të përdorimeve të veçanta, në lejen e qarkullimit u shënohet një kapacitet fiktiv për qëllime fiskale (taksash), i cili përcaktohet nga diferenca ndërmjet peshës së përgjithshme të mjetit dhe tarës së këtij mjete të pajisur me karroceri normale ose, kur nuk ekziston ky version, me tarën e automjetit (pa karroceri) të rritur me 20 për qind.

III.3.14. Në nenin 1 “Qëllimi, Objekti i Rregullores dhe Fusha e Veprimit” të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për Miratimin e Rregullores “Për Kushtet, Kriteret dhe Programet për Përgatitjen Teoriko-Praktike të Kandidatëve, si dhe Dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale

*për PërdoruesiteE Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke, si dhe Disiplinimi i Përdorimit të Makinerive të Ndërtimit”, i ndryshuar parashikohet se:*

*Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen mbi baza ligjore të aktivitetit, administrimit dhe përdorimit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre në zbatim të rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga aksidentet.*

III.3.15. Në nenin 2 “Qëllimi, Objekti i Rregullores dhe Fusha e Veprimit” të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për Miratimin e Rregullores “Për Kushtet, Kriteret dhe Programet për Përgatitjen Teoriko-Praktike të Kandidatëve, si dhe Dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për PërdoruesiteE Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke, si dhe Disiplinimi i Përdorimit të Makinerive të Ndërtimit”, i ndryshuar parashikohet se:

*Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe rregullat për: 1. përgatitjen teorike dhe praktike të shtetasve që kërkojnë të pajisen me Dëshminë e Aftësisë Profesionale DAP, të përdoruesit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke; 2. vendosjen e rregullave të administrimit, organizimit dhe përdorimit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke nga subjekte ose persona që i kanë në posedim.*

III.3.16. Në nenin 3 “Përkufizime për efekt të kësaj rregulloreje” të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për Miratimin e Rregullores “Për Kushtet, Kriteret dhe Programet për Përgatitjen Teoriko-Praktike të Kandidatëve, si dhe Dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për PërdoruesiteE Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke, si dhe Disiplinimi i Përdorimit të Makinerive të Ndërtimit”, i ndryshuar parashikohet se:

*Përkufizime për efekt të kësaj rregulloreje: a) “Dëshmia e Aftësisë Profesionale” (DAP), dokument që provon se personi zotëron njohuri të mjaftueshme teorike dhe praktike mbi përcaktimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga aksidentet në punë dhe njohurive teknike dhe profesionale për përdorimin e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke;*

III.3.17. Në nenin 7 “Kriteret për Klasifikimin dhe Emërtimin e Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke dhe Lëshimit të Dëshmisë Aftësisë Profesionale (DAP)” të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për Miratimin e Rregullores “Për Kushtet, Kriteret dhe Programet për Përgatitjen Teoriko-Praktike të Kandidatëve, si dhe Dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për PërdoruesiteE Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke, si dhe Disiplinimi i Përdorimit të Makinerive të Ndërtimit”, i ndryshuar parashikohet se:

*Në kuptimin e kësaj rregulloreje, makineritë e ndërtimit ndahen në dy grupe si:*

- 1. Makineri të rënda të punimeve të ndërtimit që përfshijnë grupin e makinerive që paraqesin vështirësi të larta teknologjike e teknike në përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre.*
- 2. Makineri të tjera ndërtimi që përfshijnë të gjitha llojet e makinerive të ndërtimit e të prodhimit të materialeve të ndërtimit, të cilat nuk përfshihen në grupin e parë.*

III.3.18. Në nenin 8 “Kriteret për Klasifikimin dhe Emërtimin e Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke dhe Lëshimit të Dëshmisë Aftësisë Profesionale (DAP)” të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për Miratimin e Rregullores “Për Kushtet, Kriteret dhe Programet për Përgatitjen Teoriko-Praktike të Kandidatëve, si dhe Dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për Përdoruesit e Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke, si dhe Disiplinimi i Përdorimit të Makinerive të Ndërtimit”, i ndryshuar parashikohet se:

*1. Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësisë Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:*

*a)- eskavator gjurmimi e ngarkimi dherash:- të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST;*

*b)- buldozer gjurmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj. manovratorëve BULDOZERIST.*

*c)- Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak manovratorëve u jepet dëshmi për AUTOMAKINIST.*

III.3.19. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.20. Konkretisht, referuar kriterit në pikën 2.3.6 për disponimin e punonjësve që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, konstatohet se autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë minimalisht **8 (tete) punonjës manovratorë** të mjeteve/makinerve të rënda specifikisht sipas profileve • *Manovrator asfaltshtruese* → 1 manovrator; • *Manovrator eskavatori* → 1 manovrator; • *Manovrator grejderi* → 1 manovrator; • *Manovrator rruli vibrues* → 2 manovrator; • *Manovrator rruli asfalti* → 1 manovrator; • *Manovrator makinerie skarifikimi asfalti* → 1 manovrator; • *Manovrator Autovinçi* → 1 manovrator. **Për cdo profil punonjesi teknik si me sipër duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme (pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates), dëshmite e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet perkatese sipas modaliteteve te urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019.** Nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “Udha” SHPK ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, me arsyetimin se: “Sipas urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019, neni 8 dhe kërkesa e DST-së pika 2.3-6 (a), kërkohen specifikisht manovratorët si më poshtë: • 1 (një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për Eskavatorist (Manovrator eskavatori) • 6 (gjashtë) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist (1 Manovrator asfaltshtruese; 1 Manovrator grejderi; 2 Manovrator rruli vibrues; 1 Manovrator rruli asfalti; 1 Manovrator makinerie skarifikimi asfalti) • 1 (një) manovrator me dëshmi të aftësive profesionale për Automakinist (Manovrator Autovinçi) Operatori ekonomik “Udha” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin provues për punonjës manovratorë të mjeteve/makinerve të rënda sipas dëshmimeve të aftësisë profesionale si më poshtë: • 1 (një) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Eskavatorist • 3 (tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist • 4 (katër) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Automakinist. Për rrjedhojë, mungojnë 3 (tre) manovratorë me dëshmi të aftësive profesionale për Buldozierist, nga 6 (gjashtë) të kërkuar dhe kërkesa e kriterit 2.3-6 (a) nuk konsiderohet e plotësuar. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur është në kundërshtim me pikën 2.3.7 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës dhe 2.3.6 (a) Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik dhe përbën kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik “Udha” sh.p.k. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion e vlefshëm sipas kërkesave të nenit 82.5 te Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”. Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimi në SPE konstaton se operatori ekonomik “Udha” SHPK ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të firmosur dhe vulosur, ku në pjesën e III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B: Deklaratë “Për e punonjësve të nevojshëm

*për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ndër të tjera ka deklaruar punonjësit e kërkuar nga autoriteti kontraktor për realizimin e kontratës, ndër të tjera edhe punonjësit e kërkuar në kriterin 2.3.6 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit. Duke qenë se operatori ekonomik “Udha” SHPK është kualifikuar në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Udha” SHPK, me anë të shkresës nr. 551/4 prot., datë 06.03.2026, i kërkoi autoriteti kontraktor, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të dorëzohet pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Udha” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Nëpërmjet shkresës me nr. 1794/1 prot., datë 10.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 551/5 prot., datë 12.03.2026 me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar nga autoriteti kontraktor dokumentacioni i dorëzuar fizikisht pranë këtij të fundit, nga operatori ekonomik “Udha” SHPK gjithsej 374 faqe.*

III.3.21. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “Udha” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet se operatori ekonomik “Udha”, shpk ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të nënshkruar dhe vulosur, si dhe ndër të tjera ka dorëzuar edhe dokumentacionin për përmbushjen e pikës 2.3.6 dëshmite e aftësisë profesionale (të vlefshme), përkatëse sipas modaliteteve të urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019. 1- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinist në emër të z. E. P; 2- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinist në emër të z. N. B; 3- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinistë në emër të z. G. Ç; 4- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për automakinistë në emër të z. SH. Ç; 5- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për eskavatorist në emër të z. F. H; 6- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për eskavatorist në emër të z. E. S; 7- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për buldozerist në emër të z. F. H; 8- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për buldozerist në emër të z. L. XH; 9- Dokumentin “Dëshmi Aftësie Profesionale” për buldozerist në emër të z. V. K; Duke marrë shkasë nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, si dhe referuar kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.6 të DST, në të cilin autoritetit kontraktor ka kërkuar që **dëshmite e aftësisë profesionale (të vlefshme), të jenë sipas modaliteteve të urdhrit Nr. 200, datë 16.5.2019.** Për një gjykim sa më të drejtë Komisioni gjykon të nevojshme ti referohet urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, konkretisht nenit 8 të Kreut III “Kriteret për Klasifikimin

*dhe Emërtimin e Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke dhe Lëshimit të Dëshmisë Aftësisë Profesionale (DAP)”, pikërisht në këtë nen ligjvënësi ka kategorizuar për secilën dëshmi për Eskavatorist, Buldozerist, Automakinist, edhe mjetet përkatëse konkretisht a) -eskavator gjërmimi e ngarkimi dherash: - të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST; b) - buldozer gjërmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj, manovratorëve u jepet dëshmi për BULDOZERIST. c) - Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për AUTOMAKINIST.*

Duke marrë shkasë nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Udha” SHPK, si dhe kriterit të formuluar nga ana e autoritetit kontraktor i cili ka drejtuar operatorët ekonomik që plotësimin e këtij kriteri ta përmbushin sipas modaliteteve të urdhrin nr. 200 datë 16.05.2009, KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe të rregullt dokumentacionin përkatës, për punonjësit e kërkuar, duke përmbushur kështu kërkesën e autoritetit kontraktor. Arsyetim i autoritetit kontraktor për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues nuk është i bazuar në ligjin dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi, konkretisht të nenit 8 të Urdhrit nr. 200, datë 16.05.2019, i cili përcakton qartë klasifikimin e makinerive të rënda dhe kategoritë përkatëse të dëshmimeve të aftësisë profesionale.

Interpretimi i Autoritetit Kontraktor, i cili kërkon një ndarje të detajuar dhe numerike të buldozieristëve për secilin funksion apo makineri të listuar në DST, bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 8 të Urdhrit nr. 200, datë 16.05.2009 pasi imponon një standard që nuk ekziston në legjislacion dhe që tejkalon kërkesat ligjore për certifikimin profesional. Për më tepër, në pikën “c” të nenit 8 të këtij urdhri përcaktohet se kategoritë e automakinistëve përfshijnë makineritë mbi bazë automjeti, duke provuar se ndarja në kategori është bërë mbi bazë funksionale dhe teknike dhe jo sipas emërimit të çdo makinerie individuale, kjo tregon qartë se ligjvënësi ka synuar një klasifikim të gjerë dhe gjithëpërfshirës dhe jo fragmentarizim të kategorive të operatorëve sipas çdo pajisjeje specifike, çka përforcon faktin se Autoriteti Kontraktor ka bërë një interpretim të gabuar dhe të paqëndrueshëm juridik, duke mos marrë në konsideratë përmbajtjen reale të kategorive të përcaktuara në Urdhrit nr. 200, është në kundërshtim me vetë aktin normativ që ai pretendon të zbatojë. Në zbatim të urdhrin 200, datë 16.05.2009, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dëshmi të aftësisë profesionale buldozerist për aq sa parashikon ky urdher, të cilin vetë autoriteti në kriterin kualifikues ka kërkuar që dëshmit të jenë sipas modaliteteve të tij. Për më tepër, operatori ekonomik ka përmbushur në mënyrë të plotë dhe funksionale kërkesën e DST-së, pasi ka paraqitur numrin e kërkuar të manovratorëve dhe kategoritë përkatëse të dëshmimeve të aftësisë profesionale, të cilat mbulojnë në mënyrë efektive dhe ligjore të gjitha profilet e kërkuara për realizimin e kontratës. Vendimi i skualifikimit bie në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili përcakton se kriteret për kualifikim duhet të jenë proporcionale dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe me nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili sanksionon parimet e barazisë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, pasi

interpretimi i bërë nga Autoriteti Kontraktor krijon barriera artificiale dhe të pajustificuara për pjesëmarrjen në procedurë, duke favorizuar një qasje formale dhe jo substanciale ndaj përmbushjes së kriteve. Gjithashtu, në bazë të nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të kryejë një vlerësim substancial të ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, ndërkohë që në rastin konkret ka aplikuar një qasje formaliste duke u fokusuar vetëm në emërtimin e dëshmive dhe jo në përmbajtjen dhe vlefshmërinë reale të tyre në raport me kërkesat e punimeve që do të realizohen, në këtë mënyrë autoriteti kontraktor është mbështetur në një interpretim formal të emërtimeve të dëshmive profesionale, duke neglizhuar përmbajtjen dhe vlefshmërinë reale të tyre dhe për aq sa vetë urdhëri 200 datë 16.05.2009 parashikon. Në thelb, Autoriteti Kontraktor ka barazuar profilet funksionale të kërkuara në DST me kategoritë e dëshmive profesionale, duke mos marrë parasysh se këto të fundit janë të standardizuara në nivel kombëtar dhe nuk mund të fragmentarizohen sipas nevojave specifike të një procedure të caktuar prokurimi, për pasojë arsyeja e skualifikimit si kategori e veçantë numerike nuk ka bazë ligjore. Në këto kushte, është e qartë se operatori ekonomik “Udha” sh.p.k. ka përmbushur kriteret e kërkuara si në aspektin sasior ashtu edhe në atë funksional dhe ligjor, dhe se skualifikimi i tij është rezultat i një interpretimi të gabuar të legjislacionit në fuqi. Në këtë kontekst, vlerësimi duhet të fokusohet nëse operatori ekonomik disponon personel të kualifikuar të mjaftueshëm për të garantuar realizimin e kontratës në mënyrë efektive dhe të sigurt, për sa kohë që nuk është analizuar nëse këto mjete do të operohen në mënyrë të njëkohshme gjatë zbatimit të kontratës. Pra, në përfundim të analizës së bërë më sipër, KPP gjykon se operatori ekonomik “Udha” Shpk, me dokumentacionin e paraqitur përmbush kriterin e vendosur në dokumentet e tenderit.

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi”*. Akoma më tej, vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 “Sigurimi i ofertës” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

i ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e punëve të kërkuara është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit për përmbushjen e kriterit plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Udha” SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Bami Holding*” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “*Pasi u njohëm me arsyet e skualifikimit nga ana e Autoritetit Kontraktor theksojmë se arsyeja e përmendur për skualifikim është e pa bazuar në dokumentat standarte të tenderit të hartuara nga vetë Autoriteti Kontraktor. Më saktësisht në dokumentat standarte të tenderit Shtojca 7 - Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, Pika 2 - Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Nempika 2.3 - Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Nempika 2.3.7 - dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë. Kandidati/ofertuesi duhet të disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera. Nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar mjete i poshtëshënuar: kamionáinë nën 3.5 ton. Copë 2 pronësi ose me qera. Sic shihet në kërkesën e dokumentave të tenderit nuk është bërë asnjë kërkesë specifike që pesha nën 3.5 ton është masa maksimale e autorizuar apo kapaciteti mbajtes i mjetit apo kerkesa referuar kategorive të mjeteve sipas kodit rrugor. Nese Autoriteti Kontraktor do ta kishte qartësuar kerkesen per kete mjet kaq specifik shoqeria jone ka mjete te tjera qe i plotesojne dhe keto kerkesa nese do te ishin te qartesuara nga ana Autoritetit Kontraktor. Ne i jemi referuar praktikës se perhereshem qe kerkesat per kapacitet jane kapacitetet mbajtese te mjetit pasi ato jane te rendesishme dhe te nevojshme per kryerjen e punimeve, ndaj kemi paraqitur mjete kamionáina me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton. Për shembull: BAMI HOLDING Shpk ka marre pjese dhe ne proceduren e tenderimit me te dhena si: Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF-67706-11-04-2025, Objekti i Kontrates/Draft Marreveshjes Kuader: ësisistemim Asfaltim i Rrugeve ne territorin e Njesise Administrative Thumane, Bashkia Kruje, Fondi limit/vlera e pritshme totale e kontratave te lidhura gjate vlefshmerise se marreveshjes kuader : 102,170,900 (njqind e dymilion e njqind e shtatedhete mije e nenteqind) lekë pa tvsh, Data: 20.11.2025 (d/m/v) ora 10:00. Ne kete procedure tenderimi nga Autoriteti Kontraktor ka gene po e njejta kerkesa per te njejtin lloj mjeti kamionáinë nën 3.5 ton dhe nga ana jone eshte paraqitur nje mjet me te njejtat karakteristika per permbushjen e kesaj kerkesa dhe nga ana e KVO te Autoritetit Kontraktor eshte konsideruar i permbushur duke na vleresuar si operator i suksesshem. Ky eshte nje vleresim me dy standarte i bere nga i njejti Autoritet Kontraktor ku nje here na vlereson si te suksesshem dhe nje here na skualifikon per paraqitjen e nje mjeti me te njejtat karakteristika per permbushjen e te njejtës kerkesa. Per sa me lart ne jemi shumë te bindur se mjeti kamioncine me targa KR7049A që ne*

kemi paraqitur në përmbushje të kriterit të kërkuar kamioncinë nën 3.5 ton. Është në përputhje të plotë dhe e plotëson kërkesën e paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit. Kjo dëshmohet me dokumentacionin e vënë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor dhe nga foto e paraqitur e mjetit ku vërehet shumë qartë dhe lehtësisht se mjeti i deklaruar është një kamioncinë me sipas Lejes Qarkullimit të mjetit masa maksimale autorizuar 5990 kg dhe masa e mjetit bosh 3420 kg diferenca mes tyre që është kapacitet mbajtës është 2570 kg pra nën 3.5 ton. Në këtë situatë theksojmë se skualifikimi i bërë nga ana e Autoritetit Kontraktor për shoqërinë tonë në këtë procedurë tenderimi është i pa drejte dhe jo në përputhje me ligjin nr.162/2020 Për Prokurimin Publik me ndryshimet VKM nr.285 datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik me ndryshimet, jo në përputhje me Dokumentat Standarte të Tenderit. Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktor që të beje rivlerësim të kësaj procedure tenderi, të ndryshojë vlerësimin e bërë dhe të beje kualifikimin e shoqërisë BAMI HOLDING Shpk si operator ekonomik i suksesshem”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të modifikuar pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, është parashikuar si vijon:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë.

- Kandidati/ofertuesi duhet të disponojë makinerite dhe mjetet si vijon në pronesi ose me qera.

<b>I. MAKINERI</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Pronësia</b>
Automjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton.	Copë	3	Pronësi ose me qera
Kamioncinë nën 3.5 ton.	Copë	2	Pronësi ose me qera
Eskavator.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshës i tonazhit të madh.	Copë	2	Pronësi ose me qera
Grejder.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Autobot uji.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Rrul asfalti.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Makineri për skarifikim asfalti.	Copë	1	Pronësi ose me qera

Autovinç	Copë	1	Pronësi ose me qera
<b>II. PAJISJE</b>			
Betonierë.	copë	1	Pronësi ose me qera
Matrapik.	Copë	1	Pronësi ose me qera
Vibrator (betoni).	copë	1	Pronësi ose me qera
Jelekë fosforeshentë/uniforma pune.	copë	40	Pronësi ose me qera
Kallëp dërrase (armaturë).	m <sup>2</sup>	140	Pronësi ose me qera
Karroca dore.	copë	1	Pronësi ose me qera
Tabela rrugore (për punime në rrugë).	copë	4	Pronësi ose me qera
Kokore për punonjësit.	copë	40	Pronësi ose me qera
Kuti e ndihmës së shpejtë.	copë	1	Pronësi ose me qera

- m) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- n) Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- o) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- p) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- q) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 08.pika C (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- r) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

**Shenim-** Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më sipër referuar.

III.4.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit referuar sistemit të prokurimeve elektronike si dhe shkresës me nr. 1795/1 prot., datë 10.03.2026, protokolluar pranë KPP-së me nr. 564/5 prot., datë 12.03.2026 rezulton se operatori ekonomik “Bami Holding” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Bami Holding” SHPK të nënshkruar dhe vulosur, ku në pjesën III Kriteret e Përzgjedhjes kualifikimit, pika D Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ndër të tjera evidentohet se ka deklaruar Kamioncinë nën 3.5 ton mjetin me targë KR 7049 A, nr. Lejes së qarkullimit KR0002638, nr. Shasisë ËDB66904210836820.
- Leje qarkullimi Nr. DRF0307720, për mjetin me targë KR 7049 A.
- Certifikatë Pronësie e Mjetit Rrugor.
- Certifikatë nr. 116 datë 18.03.2025 Për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qera brenda vendit, për mjetin KR 7049 A Daimler Benz.
- Certifikatë e kryerjes se operacionit teknik nr. 11287, datë 18.11.2024.
- Foto e mjetit.
- Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore për mjetin me targë KR 7049 A.
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, nr. 3713645, datë 12.03.2025.
- Dokumnetin Taksa Vjetore e Mjeteve, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, për mjetin me targë KR 7049 A.

III.4.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.4.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të

këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.4.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.4.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese

brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

*Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime”.*

III.4.8. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

*“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*

*c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

*ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.4.9. Në nenin 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

*1. Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod, klasifikohen si vijon:*

*a) mjete që lëvizin me forcën e krahut;*

*b) mjete të tërhequra me kafshë;*

*c) mjete me pedal;*

*d) slita;*

*e) ciklomotori;*

*f) motomjete;*

*g) automjete;*

*h) trolejbusë;*

*i) rimorkio;*

*j) makina bujqësore;*

*k) makina teknologjike;*

*l) mjete rrugore të veçanta.*

*2. Mjete me motor dhe rimorkiot e tyre, sipas shkronjave “e”, “f”, “g”, “h”, “i” “j” dhe “l”, të pikës 1, të këtij neni, klasifikohen, gjithashtu, në bazë të kategorive ndërkombëtare si më*

poshtë:

a) - *Kategoria L1: mjete me dy rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h, fuqia maksimale nuk është më shumë se 4 kË në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L2: mjete me tri rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h; rendimenti maksimal neto i fuqisë nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L3: mjete me dy rrota, pa kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L4: mjete me dy rrota, me kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L5: mjete me tri rrota të përshtatura simetrikisht, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm<sup>3</sup> dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L6: mjete me katër rrota të lehta, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 350 kg, pa përfshirë masën e baterive në rastin e automjeteve elektrike, me shpejtësi maksimale të projektuar jo më të madhe se 45 km/h, cilindrata e motorit të mos i kalojë 50 cm<sup>3</sup> dhe rendimenti maksimal neto i të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme e të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L7: mjete me katër rrota të ndryshme nga L6, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 400 kg (550 kg për automjetet e synuara për transportimin e mallrave), pa përfshirë masën e baterive, në rastin e automjeteve elektrike, dhe fuqia maksimale neto e motorit e të cilave nuk është më shumë se 15 kË;*

b) - *kategoria M: mjete me motor të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria M1: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që nuk kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit;*

- *kategoria M2: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë deri 5 tonë;*

- *kategoria M3: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 tonë;*

c) - *kategoria N: mjete me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë;*

- *kategoria N2: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 12 tonë;*

- kategoria N3: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë;

d) - kategoria O: rimorkiot (përfshirë edhe gjysmërimorkiot);

- kategoria O1: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0,75 tonë,

- kategoria O2: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0,75 tonë, por jo më të madhe se 3,5 tonë;

- kategoria O3: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë;

- kategoria O4: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë.

dh) - Kategoria T: traktorët me rrota;

- Kategoria T1: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me boshtin më të afërt te drejtuesi, që ka gjerësi minimale zinxhiri prej jo më pak se 1150 mm, me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 1 000 mm;

- Kategoria T2: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me gjerësi minimale zinxhiri prej më pak se 1150 mm, e një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 600 mm;

- Kategoria T3: traktorët e pajisur me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h dhe me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej jo më shumë se 600 kg;

- Kategoria T4: traktorët e pajisur me rrota për qëllime të veçanta, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;

- Kategoria T5: traktorët e pajisur me rrota me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;

- Kategoria C: traktorët me zinxhirë të pandërprerë;

Traktorët me zinxhirë të pandërprerë që shtyhen dhe drejtohen nga zinxhirë të pandërprerë dhe kategoritë e të cilëve, C1 deri C5, përcaktohen në analogji me kategoritë T1 deri T5.

III.4.10. Në nenin 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar përmasat gabaritë kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, kurse për normat konstruktive dhe sistemet e pajimit duhet të respektojnë dispozitat e nenit 105.

2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit.

3. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar dispozitat e neneve 98, 106, 107, 110 dhe 111. Makinat teknologjike që, për kërkesa funksionale, i tejkalojnë përmasat gabaritë kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, konsiderohen makina teknologjike jashtë norme dhe për to zbatohen normat e parashikuara në nenin 103, pika 8.

4. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit.

5. Mënyrat e zbatimit të pikave 2 dhe 3, si dhe ato që kanë të bëjnë me modifikimet në emërtimin

*e mjeteve, përmbajtjen dhe karakteristikat e lejes së qarkullimit, janë përcaktuar me udhëzime të organeve të ministrisë përgjegjës për transportin.*

*6. Mënyrat për regjistrimin dhe targimin përcaktohen në akte të veçanta.*

*7. Cilido që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me të njëjtat sanksione të parashikuara për të njëjtat shkelje të kryera me makinat bujqësore.*

III.4.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.12. Konkretisht, referuar kriterit në pikën 2.3.7 për disponimin e mjeteve që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, konstatohet se autoriteti kontraktor ndër të tjera ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë 2 kamioncina nën 3.5 ton në pronësi ose me qera. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, me arsyetimin se: *“Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik “Bami Holding” sh.p.k, si dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezulton se: Sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2.3.7 të Dokumentave Standarde të Tenderit, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik që nevojiten në ekzekutimin e kontratës, Për mjetin me targë KR7049A, të deklaruar kamionçinë nën 3.5 ton, referuar dokumentacionit provues, në lejen e qarkullimit me nr.DRF0307720 pika 23.Masa maksimale e autorizuar është 5990 kg dhe kodi i karrocërisë F3-Kamion. Gjithashtu, në certifikatën e kontrollit teknik mjeti i përket kategorisë N2 (Kamion) dhe në certifikatën e pronësisë së mjetit është F3-Kamion. Nga këto të dhëna rezulton se mjeti tejkalon tonazhin e kërkuar, duke mos përmbushur kriterin 2.3.7 për “Kamioncinë nën 3.5 ton” i cili sipas ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” neni 47, pika 2 (c) Kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3.5 ton ndërsa N2 (Kamion): mjete të destinuara për transport*

mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë me të madhe se 3.5 ton dhe jo me të madhe se 12 ton, si dhe neni 54 pika 1(c). Për rrjedhojë, kërkesa e kriterit 2.3.7 të Dokumentave Standarde të Tenderit për kamioncinë nën 3.5 ton, nuk konsiderohet e plotësuar. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Bami Holding” sh.p.k është në kundërshtim me pikën 2.3.7 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës dhe përbën kusht për skualifikim. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesave të nenit 82.5 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26.6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimi në SPE konstaton se operatori ekonomik “Bami Holding” SHPK ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të firmosur dhe vulosur, ku në pjesën e III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ndër të tjera ka deklaruar: “Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të më vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar kontratën si më poshtë: .....Kamioncinë nën 3.5 ton, AB4 809 SH, me nr. leje qarkullimi TRD03843124, dhe nr. Shasie ĒDB9062351N460109, kamioncinë nën 3.5 ton KR 7049 A, me nr. leje qarkullimi TKR0002638, dhe nr. shasie ĒDB66904210836820”. Referuar Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues e ka plotësuar atë në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.7 të shtojcës nr. 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të dokumentave të tenderit. Referuar pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, konstatohet, se ligjvënësi ka parashikuar se “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”. Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik “Bami Holding” SHPK është kualifikuar në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Bami Holding” SHPK, me anë të shkresës nr. 564/4 prot., datë 06.03.2026, i kërkoi autoriteti kontraktor, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “Bami Holding” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Nëpërmjet shkresës me nr. 1795/1 prot., datë 10.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 564/5 prot., datë 12.03.2026 me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar nga autoriteti kontraktor dokumentacioni i dorëzuar fizikisht pranë këtij të fundit, nga operatori ekonomik “Bami Holding” SHPK gjithsej 1312 faqe.

III.4.13. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “Bami Holding” SHPK, si operator

ekonomik i kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet se operatori ekonomik “Bami Holding”, shpk ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të nënshkruar dhe vulosur, si dhe ndër të tjera ka dorëzuar edhe - *Leje qarkullimi Nr. DRF0307720, për mjetin me targë KR 7049 A. - Certifikatë Pronësie e Mjetit Rrugor. - Certifikatë nr. 116 datë 18.03.2025 Për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qera brenda vendit, për mjetin KR 7049 A Daimler Benz. - Certifikatë e kryerjes se operacionit teknik nr. 11287, datë 18.11.2024. - Foto e mjetit. - Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore për mjetin me targë KR 7049 A. - Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, nr. 3713645, datë 12.03.2025. - Dokumnetin Taksa Vjetore e Mjeteve, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, për mjetin me targë KR 7049 A. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Bami Holding” SHPK, si dhe nga verifikimi i lejes së qarkullimit nr. DRF0307720 për mjetin me targë KR 7049 A Komisioni konstaton, se në lejen e qarkullimit në pikën 23. Masa maksimale e autorizuar (kg) përcaktohet 5990, ndërsa në pikën 24. Masa e mjetit bosh (kg) përcaktohet 3420. Nga ky dokumentacion rezulton se, mjete me targë KR 7049 A ka tonazh transportues 2.570 ton, duke përmbushur në këtë mënyrë kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.7 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Në këto kushte arsyeja e skualifikimit të KVO-së nuk qëndron.*

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Bami Holding” SHPK qëndron.

#### **Vendos:**

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Udha*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “*’Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë*”, me fond limit 197’903’543 (*njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre*) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.
2. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Bami Holding*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “*Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë*”, me fond limit 197’903’543 (*njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre*) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “*Udha*” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operatorë ekonomik.
  4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “*Bami Holding*” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operatorë ekonomik.
  5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Udha*” SHPK.
  7. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Bami Holding*” SHPK.
  8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  9. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

